

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

BUJQËSI

Niveli I

Kodi: H-I-15

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2015

Përmbajtja

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli I.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Bujqësi” niveli I.
2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me punimet dhe shërbimet në bujqësi”*. Zhvillimi te nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës në fushën e bujqësisë që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MMSR përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I, nxënësi do të kenë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tyre dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tyre dhe të shfaqin gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojnë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin “**Bujqësi**”, niveli I, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrijë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të respektojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.
- Të sigurojë cilësi të kënaqshme në kryerjen e proceseve të punëve në bujqësi.
- Të kryejë procese të thjeshta pune të marrjes së mostrës së tokës pës p analizë.
- Të kryejë procese pune të kultivimit të perimeve me fidanë.
- Të kryejë procese pune të kujdesit për kafshët bujqësore.
- Të kryejë procese pune të kultivimit të grurit.
- Të kryejë procese pune të kultivimit të misrit.
- Të drejtojë dhe përdorë traktorin me rrota
- Të kryejë procese pune të mbjelljes së fidanit të pemëve frutore.
- Të kryejë procese pune të mirëmbajtjes së fermës bujqësore e blegtorale.
- Të kryejë procese pune të punimit të mekanizuar të tokës.
- Të kryejë procese pune të ujitjes së bimëve të arave dhe të perimeve.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim profesional.

Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punonjës gjysëm i kualifikuar në ndërmarrje/ferma të ndryshme bujqësore dhe blegtorale ose veprimtari të tjera që veprojnë në fushën e bujqësisë. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në fushën e prodhimeve bujqësore. Përsa i përket arsimimit të mëtejshëm, nxënësi ka mundësi të vazhdojë studimet në nivelin II të arsimit profesional, në një prej profileve të drejtimit mësimor “Bujqësi”. Me vijimin e mëtejshëm të arsimit

profesional në nivelin III, nxënësi fiton “maturën profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I

| Plani mësimor për drejtimin “Bujqësi” Niveli I | | | | |
|--|--------------|--|-------------------------------|-------------------------------|
| Nr | Kodi | Lëndët dhe modulet mësimore | Niveli I | |
| | | | Orët javore/vjetore | |
| | | | Klasa 10 | Klasa 11 |
| A. | | Lëndët e përgjithshme (Gjithsej) | 15/17 (540/ 612) | 11/13 (374/ 442) |
| 1 | | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 2 | 1 |
| 2 | | Gjuhë e huaj | 2 | 2 |
| 3 | | Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë) | (2) | (2) |
| 4 | | Qytetari | 2 | - |
| 5 | | Histori | 1 | 1 |
| 6 | | Matematikë | 2 | 1 |
| 7 | | Fizikë | 2 | 1 |
| 8 | | Kimi | 1 | 2 |
| 9 | | Teknologji informimi e komunikimi | 1 | 1 |
| 10 | | Edukim fizik | 2 | 1 |
| 11 | | Edukim për karrierën | - | 1 |
| B. | | Lëndët profesionale (Gjithsej) | 10(360) | 8(272) |
| 1 | L-14-039-15 | Bazat e bujqësisë | 2 | 1 |
| 2 | L-14-040-15 | Perime dhe lule | 2 | 1 |
| 4 | L-28-041-15 | Mbarështrim kafshësh bujqësore | 2 | - |
| 5 | L-04-042-15 | Bazat e mekanikës bujqësore | 2 | 2 |
| 6 | L-14-043-15 | Bimët e arave | 2 | - |
| 7 | L-14-044-15 | Pemët frutore | - | 2 |
| 8 | L-19-045-15 | Bazat e veterinarisë | - | 2 |
| C. | | Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej) | 5 (180) | 10 (340) |
| 1 | M-14-1133-15 | Marrja e mostrës së tokës për analizë | 36 | - |
| 2 | M-14-744-11 | Kultivimi i perimeve me fidanë | 36 | - |
| 3 | M-28-1134-15 | Kujdesi për kafshët bujqësore | 54 | - |
| 4 | M-14-137-15 | Kultivimi i grurit | 54 | - |
| 5 | M-14-138-11 | Kultivimi i misrit | - | 51 |
| 6 | M-04-1135-15 | Drejtimi dhe përdorimi i traktorit me rrota | - | 85 |
| 7 | M-14-140-15 | Mbjellja e fidanit të pemëve frutore | - | 33 |
| 8 | M-14-141-15 | Mirëmbajtja e fermës bujqësore dhe blegtorale | - | 69 |
| 9 | M-14-142-11 | Punimi i mekanizuar i tokës | - | 51 |
| 10 | M-14-1136-15 | Ujitja e bimëve të arave dhe e perimeve | - | 51 |
| D. | | Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të | 1 (36) | 2 (68) |

| | | detyruar (Gjithsej) | | |
|---|--------------|---|---------------------------------|---------------------------------|
| 1 | M-14-146-09 | Kultivimi i luleve në mjedise të hapura | 36 | - |
| 2 | M-28-147-09 | Kujdesi gjatë rritjes së bletëve | 36 | |
| 3 | M-14-1137-15 | Përgatitja e kompostove | 36 | - |
| 4 | M-04-148-11 | Mirëmbajtja e makinave bujqësore | - | 34 |
| 5 | M-14-149-15 | Shtimi me copa i drufrutorëve | - | 34 |
| 6 | M-14-150-15 | Mbjellja e fidanit të hardhisë | - | 34 |
| 7 | M-28-1138-15 | Mjelja e kafshëve bujqësore | - | 34 |
| | | Gjithsej A+B+C+D | 31/33 (1116/ 1188) | 31/33 (1054/ 1122) |

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 11, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 1 javë për provimin e teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 33 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë

reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “Bujqësi”, niveli I.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Bujqësi”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Bujqësi”, niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e bujqësisë e blegtorisë, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Bujqësi”, niveli I

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi” niveli I shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MMSR, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e bujqësisë” (L-14-039-15) Kl. 10 – 72 orë dhe kl.11- 34 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e bujqësisë”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e bujqësisë”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e lëndës dhe rëndësinë e saj.
- Të përshkruajnë kuptimin, elementet përbërëse të ekosistemit, sistemet ekologjike dhe ndikimi i tyre në prodhimin bujqësor.
- Të përshkruajnë përbërësit e mjedisit, karakteristikat dhe sjelljen e tyre në një ekosistem, si dhe ndikimin e njeriut me anë të veprimtarisë së tij, veçanërisht në drejtim të ndotjes, si dhe mënyrat e shmangies së ndotjes.
- Të përshkruajnë atmosferën dhe elementët përbërës të saj, dukuritë atmosferike, si dhe faktorët klimatik që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e bimëve.
- Të përcaktojnë zonat dhe nënzonat klimatike të vendit tonë, si dhe masat mbrojtëse ndaj ndryshimeve klimatike.
- Të përshkruajnë shpërndarjen e bimëve në botë, qendrat e origjinës, faktorët që kushtëzojnë përhapjen dhe kufizimin e bimëve.
- Të analizojnë ndikimin e faktorëve mjedisor në prodhimin bujqësor (temperatura, lagështira, drita dhe CO₂).
- Të tregojnë rëndësinë e sistematikës së bimëve, klasifikimin botanik të bimëve nga ai bujqësor e biologjik, si dhe tetë nënndarjet e botës bimore sipas Lineut.
- Të përshkruajnë organizimin e qelizës, ndërtimin dhe funksionet kryesore të pjesëve të bimës dhe proceset bazë të fiziologjisë së bimëve (fotosinteza, frymëmarrja dhe transpirimi).
- Të krahasojë proceset jetësore të bimës: fotosintezës, transpirimit, dhe frymëmarrjes.
- Të përshkruajë rolin e hormoneve në jetën e bimës dhe shumëzimin seksual dhe joseksual të bimëve, si dhe cilësitë dalluese të farës.
- Të theksojnë kuptimin e konceptit “rritje” dhe “zhvillim”, si dhe fazat përkatëse të tyre.
- Të përshkruajnë ndryshimet e zhvillimit të bimëve një, dy dhe shumë vjeçare.
- Të përshkruajnë fazat e mbirjes të bimët një dhe dythelbore duke bërë krahasimin midis tyre, faktorët e rritjes dhe zhvillimit të bimës, faktorët gjenetikë tokësorë dhe klimatikë që rregullojnë pjekjen e bimës.
- Të përshkruajnë mënyrat e shtimit me farë dhe vegjetativ të bimëve bujqësore, rolin e farishtes për bimët që mbillen me fara të imëta, si dhe domosdoshmërinë e farishteve dhe fidanishteve në pemët frutore.
- Të përshkruajnë konceptin mbi tokën, tokën bujqësore, pjellorinë dhe prodhimtarinë e saj.
- Të përshkruajnë horizontet në një profil toke dhe përbërësit për çdo horizont.
- Të përshkruajnë hapat për marrjen e mostrës së tokës për analizë.
- përbërësit inorganik, organik, gjallesat, si dhe ujin, ajrin dhe temperaturën e tokës.
- tretësirën tokësore dhe reaksionin e tokës (pH), si dhe masat përmirësuese të pH.
- Të rendisin dhe përshkruajnë cilësitë fizike të tokës.
- Të theksojnë dukurinë e gërryerjes, faktorët që e shkaktojnë dhe masat mbrojtëse kundër saj.
- Të përshkruajnë parimet e përgjithshme dhe rolin qarkullimit bujqësor në ruajtjen e pjellorisë së tokës, si dhe skemat kryesore të qarkullimit bujqësor sipas zonave.

- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kulturave bujqësore që nga proceset e përgatitjes së tokës deri në vjeljen e prodhimit.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e bujqësisë”, kl. 10 – 72 orë**

| | | |
|----------------|---|-------|
| Tema 1 | Njohuri të përgjithshme për bazat e bujqësisë | 2 orë |
| Tema 2 | Kuptimi për ekosistemin | 6 orë |
| Tema 3 | Klima | 6 orë |
| Tema 4 | Bimët dhe mjedisi | 8 orë |
| Tema 5 | Klasifikimi i bimëve | 6 orë |
| Tema 6 | Morfologjia dhe fiziologjia e bimëve | 8 orë |
| Tema 7 | Rritja dhe zhvillimi i bimëve | 4 orë |
| Tema 8 | Shumëzimi i bimëve | 8 orë |
| Tema 9 | Toka bujqësore. Horizonti dhe përbërja e tokës. | 4 orë |
| Tema 10 | Tretësira tokësore dhe reaksioni i tokës | 4 orë |
| Tema 11 | Cilësitë fizike të tokës | 2 orë |
| Tema 12 | Gërryerja e tokës dhe masat mbrojtëse ndaj saj | 2 orë |
| Tema 13 | Qarkullimi bujqësor | 4 orë |
| Tema 14 | Agroteknologjia e kulturave bujqësore | 8 orë |

- **Synimet e lëndës “Bazat e bujqësisë”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e bujqësisë”, klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e njohjes së barërave të këqija, si dhe dëmet që sjellin ato në prodhimin bujqësor, klasifikimin e barërave e këqija sipas jetëgjatësisë së tyre dhe kriterit të dëmit për bimët dhe për blegtorinë.
- Të përshkruajnë karakteristikat e barërave të këqija kryesore, mënyrat e shumimit e të përhapjes, metodat e luftimit biologjik, teknologjik dhe kimik të barërave të këqija.
- Të përshkruajnë elementet ushqyese kryesore të tokës, rolin e tyre, llojet më të përdorshme të plehrave, mënyrat, sasinë dhe kohën e përdorimit të plehrave.
- Të përshkruajnë diagnostikimin gjethor, plehrat kryesore kimike dhe organike.
- Të shpjegojnë rëndësinë e plehrit të gjelbër sipas bimëve që përdoren.
- Të thesojnë rëndësinë e njohjes së sëmundjeve të bimëve bujqësore, kuptimin e konceptit ‘sëmundje’, sëmundjet infektive dhe parazitare, si dhe shkaktarët kryesorë të tyre.
- Të shpjegojnë dëmtuesit kryesorë të bimëve dhe metodat e ndryshme të luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve .
- Të shpjegojnë objektin e shkencës së përmirësimit gjenetik të bimëve, terminologjinë që përdor kjo shkencë, grumbullimin, studimin dhe ruajtjen e materialit fillestar.
- Të përshkruajnë harmonizimin e ekonomisë së fermës me natyrën, proceset jetësore natyrore.
- Të shpjegojnë se çfarë është ekonomia e mbyllur.
- Të theksojnë rëndësinë dhe mënyrat e kombinimit të prodhimit bujqësor me prodhimin blegtoral.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e bujqësisë”, kl. 11 – 34 orë**

| | | |
|---------------|--------------------|-------|
| Tema 1 | Barërat e këqija | 6 orë |
| Tema 2 | Plehërimi i bimëve | 8 orë |

| | | |
|---------------|--|-------|
| Tema 3 | Njohuri të përgjithshme për mbrojtjen e bimëve | 8 orë |
| Tema 4 | Njohuri fillestare gjenetike | 4 orë |
| Tema 5 | Prodhimet biologjikisht të pastra | 8 orë |

2. Lënda “Perime dhe lule” (L-14-040-15) Kl. 10 - 72 orë dhe kl.11- 34 orë

• Synimet e lëndës “Perime dhe lule”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Perime dhe lule” klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e kultivimit të perimeve, vlerat ushqimore dhe kurative të tyre.
- Të përshkruajnë kërkesat e perimeve për klimë, tokë dhe elemente ushqyese.
- Të dallojnë perimet sipas grupimeve të tyre botanike, si dhe atyre që shtohen me farë nga ato me pjesë vegjetative.
- Të shpjegojnë kriteret që nevojiten për ngritjen e perimores.
- Të përshkruajnë llojet e shtretërve, zgjedhjen e vendit, mënyrat e ngrohjes, përgatitjen e dherishtes dhe kubikëve.
- Të shpjegojnë përgatitjen e fidanëve në shtretër, shërbimet, artisjen dhe kalitjen e fidanëve.
- Të theksojnë rëndësinë ekonomike të serave dhe kriteret e vendit të ndërtimit të serave, llojet e serave, si dhe planimetra e bllokut të tyre.
- Të përshkruajnë serat me ngrohje qendrore dhe diellore.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes zambakore (qepa, preshi, hudhra dhe asparagu).
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyese të perimeve të familjes zambakore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit të prodhimit të hershëm, të mesëm dhe të vonë të perimeve zambakore: përgatitja e fidaneve, mbjellja, shërbimet kulturore dhe vjelja.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes bostanore (kungulli, kastravec, shalqini dhe pjepr).
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyese të perimeve të familjes bostanore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit të perimeve bostanore: përgatitja e fidanëve, mbjellja, shërbimet kulturore dhe vjelja.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes kryqore (lakra, lulelakra, brokoli, repa dhe rilka).
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyese të perimeve të familjes kryqore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit të perimeve kryqore: përgatitja e fidanëve, mbjellja, shërbimet kulturore dhe vjelja.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes kenopodiore (spinaqi, pazia, panxhari i kuq etj).
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyese të perimeve të familjes kenopodiore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit të perimeve kenopodiore: përgatitja e fidanëve, mbjellja, shërbimet kulturore dhe vjelja.

- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes kompozite (sallata, çikorja, angjinaria etj).
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyes të perimeve të familjes kompozite.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit të perimeve kompozite: përgatitja e fidanëve, mbjellja, shërbimet kulturore dhe vjelja.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes ombrellore (karrota, majdanoz, kopër, selino, finok etj).
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyes të perimeve të familjes ombrellore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit të perimeve ombrellore, shërbimet kulturore dhe vjelja.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes bishtajore (fasulja bishtajë, bizelja, batha,) e mëllagore (bamja).
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyes të perimeve të familjes bishtajore e mëllagore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit të perimeve bishtajore e mëllagore, shërbimet kulturore dhe vjelja.
- Të hartojnë vargëzimin për një furnizim të rregullt me perime të freskëta në zonën fushore dhe malore.
- Të rendisin kriteret mbi të cilat bazohet bashkshoqërimi i perimeve.
- Të përshkruajnë një skemë të dhënë të perimeve të dyta perimore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Perime dhe lule”, kl. 10 – 72 orë**

| | | |
|----------------|---|--------|
| Tema 1 | Rëndësia e kultivimit të perimeve dhe vlerat e përdorimit të tyre | 2 orë |
| Tema 2 | Kërkesat e perimeve ndaj kushteve të mjedisit | 6 orë |
| Tema 3 | Klasifikimi dhe shtimi i perimeve | 2 orë |
| Tema 4 | Perimorja dhe kriteret e ngritjes së saj | 2 orë |
| Tema 5 | Shtretërit dhe ngritja e tyre | 4 orë |
| Tema 6 | Serrat dhe ngritja e tyre | 6 orë |
| Tema 7 | Perimet e familjes solanore | 10 orë |
| Tema 8 | Perimet e familjes bostanore | 8 ore |
| Tema 9 | Perimet e familjes zambakore | 6 orë |
| Tema 10 | Perimet e familjes kryqore | 4 orë |
| Tema 11 | Perimet e familjes kenopodiore | 4 orë |
| Tema 12 | Perimet e familjes bishtajore e mëllagore | 4 orë |
| Tema 13 | Perimet e familjes kompozite | 4 orë |
| Tema 14 | Perimet e familjes ombrellore | 4 orë |
| Tema 15 | Vargëzimi dhe bashkëshoqërimi i kulturave perimore | 6 orë |

• **Synimet e lëndës “Perime dhe lule”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Perime dhe lule” klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë estetike dhe mjedisore të kultivimit të bimëve zbukuruese;
- Të përshkruajnë kërkesat e bimëve zbukuruese për klimë, tokë dhe element ushqyes;
- Të rendisin përbërësit e tokave (llojet e dherave) që përdoren në luletari;
- Të klasifikojnë bimët zbukuruese sipas ciklit jetësor dhe mjedisit ku kultivohen;

- Të përshkruajnë shumimin me farë të bimëve zbukuruese, si dhe kushtet që ndikojnë në ruajtjen e fares;
- Të përshkruajnë mënyrat e ndryshme të shumimit vegetativ;
- Të rendisin proceset agroteknologjike të kultivimit të bimëve zbukuruese, që nga punimi i tokës e deri në shërbimet kulturore;
- Të rendisin bimët zbukuruese që kultivohen në fushë të hapur;
- Të përshkruajnë bimët zbukuruese njëvjeçare më të përhapura të fushës si: agerati, begonja, bizelja erëmirë, flokësi, kalendula, kokoçeli, lulegojëujku, lulefshesa, lulekadifeja, lulekokëzogu, lulelafshëgjeli, lulezjarri, petunjia, bordullaku etj.;
- Të përshkruajnë bimët zbukuruese dyvjeçare më të përhapura të fushës si: flokëza, lulja e dhenve, lulekëmbana, lulesheboja, lulja mos më harro, mëllaga e detit, vjollca etj.;
- Të përshkruajnë bimët zbukuruese shumëvjeçare më të përhapura të fushës si: aguliçëja, akilega, arabëza, bozhurja, lulebora, margarita, lulevjeshta, lulezemra, lulekuqi, karafili, trëndafili;
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të trëndafilit dhe karafilit;
- Të përshkruajnë bimët zbukuruese më të përhapura të mjediseve të mbrojtura si: aguliçja, abutilonji, aralia, asparagu, begonjiet, çiklamini, fikusi, gjethemisri, shqiponja, lulevathi, sanseveria, difenbahia, kamelia, lulkevathi, palma e ujit, trëndafili kinez, strelicia (lulekëblejleku) etj.;
- Të përshkruajnë bimët zbukuruese më të përhapura qepore, zhardhokore, rizomatore si: tulipani, gladiola, lulepatatja, narçizi, shpatorja, zambaku, zymbyli, kalla, etj., dhe mishtore (lloje të ndryshme kaktusesh);
- Të dallojnë kërpudhat e ngrënshme nga ato helmuese;
- Të përshkruajnë konceptet kryesore në lidhje me hidroponinë.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Perime dhe lule”, kl. 11 – 34 orë**

| | | |
|----------------|---|-------|
| Tema 1 | Rëndësia dhe roli i bimëve zbukuruese në mjedis | 1 orë |
| Tema 2 | Kërkesat e bimëve zbukuruese për klimë, tokë dhe element ushqyes | 3 orë |
| Tema 3 | Klasifikimi dhe shumimi i bimëve zbukuruese | 3 orë |
| Tema 4 | Shtretërit dhe mjediset e mbrojtura për kultivimin e bimëve zbukuruese | 2 orë |
| Tema 5 | Shërbimet kulturore në bimët zbukuruese në fushë dhe mjedis të mbrojtur | 4 orë |
| Tema 6 | Bimët zbukuruese që kultivohen në mjedis të hapur | 8 orë |
| Tema 7 | Bimët zbukuruese që kultivohen në mjediset e mbrojtura | 3 orë |
| Tema 8 | Bimët zbukuruese qepore, zhardhokore, rizomore dhe mishtore | 3 orë |
| Tema 9 | Kultivimi i kërpudhave | 3 orë |
| Tema 10 | Njohuri të përgjithshme mbi hidroponinë | 3 orë |

4. Lënda “Mbarështrim kafshësh bujqësore” (L-28-041-15) Kl. 10 - 72 orë

• **Synimet e lëndës “Mbarështrim kafshësh bujqësore”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbarështrim kafshësh bujqësore”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e rritjes së kafshëve, shpendëve, krimbit të mëndafshit, bletëve dhe peshkut në përputhje me zhvillimin aktual të vendit;

- Të theksojnë karakteristikat e zgjedhjes së racave më të përshtatshme për rritje në lidhje me kushtet e fermës;
- Të përshkruajnë shërbimet që kryhen te kafshët për mbajtjen pastër të trupit të tyre;
- Të përshkruajnë veçoritë biologjike dhe karakteristikat prodhuese të gjedhit, derrit, shpendëve, etj.;
- Të shpjegojnë mënyrat e shumëzimit dhe të riprodhimit të grupeve kryesore të kafshëve bujqësore;
- Të përshkruajnë teknologjitë e trajtimit dhe të ushqyerit e kategorive kryesore brenda secilit grupim të kafshëve në kushtet e fermave të vogla dhe të mëdha;
- Të hartojnë racione të thjeshta ushqimore për kafshë të ndryshme sipas drejtimit ekonomik të tyre;
- Të klasifikojnë ushqimet dhe të përcaktojnë cilësinë, sasinë dhe mënyrën e dhënies së tyre;
- Të përshkruajnë elementët bazë të higjienës së ndërtesës, të trupit të kafshës dhe të produkteve blegtorale;
- Të hartojnë racione të thjeshta ushqimore për kafshë të ndryshme sipas drejtimit ekonomik të tyre;
- Të përshkruajnë racat e grupeve të ndryshme të kafshëve duke u bazuar në eksterior.
- Të përshkruajnë drejtimin ekonomik të kafshës duke vlerësuar treguesit e eksteriorit dhe të konstitucionit;
- Të dallojnë shenjat e pjekurisë seksuale dhe të përcaktojnë kohën e përshtatshme për ndërzim në të gjitha grupet e kafshëve;
- Të dallojnë shenjat e pjelljes dhe të ndihmojnë kafshën e rritur dhe të vegjëlit pas pjelljes.
- Të përshkruajnë mjeljen me dorë dhe me makinnë mjelëse;
- Të ushqejnë kafshët sipas kategorive, gjendjes fiziologjike dhe drejtimit ekonomik të tyre.
- Të përshkruajnë higjienën trupore të kafshës, stallës dhe të qumështit;
- Të përshkruajnë kushtet e rritjes dhe të kultivimit të peshkut, të bletës dhe të krimbit të mëndafshit.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbarështrim kafshësh bujqësore”, kl. 10 – 72 orë**

| | | |
|----------------|---|-------|
| Tema 1 | Rëndësia e prodhimit blegtoral dhe përmirësimi i sistemit zooteknik | 2 orë |
| Tema 2 | Anatomia e trupit të kafshës | 3 orë |
| Tema 3 | Higjiena e trupit të kafshëve | 3 orë |
| Tema 4 | Ushqimet për blegtorinë | 8 orë |
| Tema 5 | Racat e kafshëve | 2 orë |
| Tema 6 | Njohuri të përgjithshme mbi mbarështrimin e gjedhit | 6 orë |
| Tema 7 | Trajtimi i lopëve para dhe pas pjelljes | 5 orë |
| Tema 8 | Të ushqyerit e lopëve sipas fazave fiziologjike | 7 orë |
| Tema 9 | Njohuri mbi rritjen dhe mbarështrimin e derrit | 8 orë |
| Tema 10 | Njohuri mbi rritjen e shpendëve | 8 orë |
| Tema 11 | Njohuri mbi rritjen dhe mbarështrimin e bagëtive të imta | 5 orë |
| Tema 12 | Njohuri mbi rritjen e njëhundrakëve | 5 orë |
| Tema 13 | Njohuri mbi rritjen e krimbit të mëndafshit | 2 orë |
| Tema 14 | Njohuri mbi rritjen e bletëve | 4 orë |
| Tema 15 | Njohuri mbi rritjen artificiale të peshkut | 4 orë |

5. Lënda “Bazat e mekanikës bujqësore” (L-04-042-15) Kl. 10 - 72 orë, Kl. 11 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e mekanikës bujqësore”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e mekanikës bujqësore”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë, përdorimet dhe funksionet e veglave të dorës që përdoren në bujqësi.
- Të dallojnë llojet e traktorëve bujqësorë sipas materialit dhe përdorimit të tyre.
- Të përshkruajnë pjesët kryesore të traktorit, motorët me djegje të brendshme.
- Të përshkruajnë ciklin e punës me katër dhe dy kohë të motorëve me karburator dhe diezel.
- Të përshkruajnë sistemin bjellë-manivelë, detalet e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve
- Të përshkruajnë sistemin e ftohjes me ujë dhe ajër.
- Të përshkruajnë sistemin e vajojsjes dhe të ventilimit të karterit.
- Të përshkruajnë elementet kryesore të sistemit të ushqimit të motorit me karburator dhe diezel.
- Të përshkruajnë sistemin e ndezjes me bateri dhe magnet të motorit me karburator
- Të përshkruajnë elementet dhe funksionin e mekanizmave të transmisionit të fuqisë: friksioni, kutia e ndërrimit të shpejtësisë, transmisioni kryesor, diferenciali dhe gjysmëboshtet.
- Të përshkruajnë pjesën lëvizëse të traktorëve me rrota dhe zinxhirë.
- Të rendisin elementet përbërëse të sistemit të drejtimit, si dhe të dallojnë sistemin mekanik nga ai hidraulik.
- Të rendisin mënyrat e transmetimit të forcës së frenimit.
- Të përshkruajnë sistemin e ecjes së traktorëve.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionin e mekanizmit ngritës-hidraulik.
- Të përshkruajnë boshtin e marrjes së fuqisë (bmf) dhe rolin e tij.
- Të përshkruajnë rëndësinë, cilësinë dhe llojet e karburanteve dhe lubrifikantëve.
- Të rendisin defektet kryesore në mekanizmat dhe sistemet e motorëve me djegje të brendshme të sipërpërmendura.
- Të rendisin llojet e shërbimeve që i kryhen traktorit.

▪ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës ”Bazat e mekanikës bujqësore” kl. 10 - 72 orë

| | | |
|----------------|--|-------|
| Tema 1 | Veglat e dorës që përdoren në bujqësi e blegtori | 2 orë |
| Tema 2 | Njohuri të përgjithshme për traktorët bujqësorë | 3 orë |
| Tema 3 | Klasifikimi i motorëve me djegje të brendshme | 1 orë |
| Tema 4 | Mekanizmi bjellë-manivelë | 3 orë |
| Tema 5 | Mekanizmi i shpërndarjes së gazeve | 3 orë |
| Tema 6 | Sistemi i ushqimit në motorët me karburator | 3 orë |
| Tema 7 | Sistemi i ushqimit në motorët “diesel” | 2 orë |
| Tema 8 | Sistemi i ndezjes | 3 orë |
| Tema 9 | Sistemi i vajojsjes | 3 orë |
| Tema 10 | Sistemi i ftohjes | 3 orë |
| Tema 11 | Sistemi i lëshimit | 2 orë |
| Tema 12 | Skema e transmisionit të fuqisë së traktorit me goma | 1 orë |
| Tema 13 | Friksionet | 2 orë |
| Tema 14 | Kutia e shpejtësisë | 3 orë |

| | | |
|----------------|---|--------|
| Tema 15 | Transmesioni kardanik | 1 orë |
| Tema 16 | Transmesioni qendror | 1 orë |
| Tema 17 | Diferenciali, transmisionet anësore dhe gjysëmboshtet | 3 orë |
| Tema 18 | Veçoritë e transmisionit të fuqisë të traktorit me zinxhirë | 2 orë |
| Tema 19 | Mekanizmat e tjerë të traktorit me goma | 8 orë |
| Tema 20 | Sistemet e tjerë të traktorit me goma | 8 orë |
| Tema 21 | Karburantët dhe lubrifikantët | 3 orë |
| Tema 22 | Mirëmbajtja e traktorit | 10 orë |
| Tema 23 | Masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit | 2 orë |

• **Synimet e lëndës "Bazat e mekanikës bujqësore", kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Bazat e mekanikës bujqësore" klasa 11, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë bazën materialo-teknike të mekanizmit të bujqësisë, si dhe marrëdhëniet midis makinave dhe mjedisit bujqësor
- Të tregojnë strukturën dhe llojet e makinave të punës në bujqësi
- Të përshkruajnë makinat tokëpunuese në përshtatje me mënyrat e punimit
- Të rendisin plugjet me veshë, llojet, funksionimin, si dhe të listojnë organet e plugjeve me veshë
- Të shpjegojnë procesin e plugimit, si dhe të tregojnë si lidhet plugu në traktor, mënyrat e rregullimit të plugjeve e korrigjimet gjatë punës
- Të përshkruajnë makinat shkallmuese e shkriçeruese të tokës në thellësi
- Të listojnë makinat për punimin sipërfaqësor të tokës
- Të shpjegojnë përdorimin, ndërtimin dhe funksionimin e tyre (disqet, lesat, kultivatorët, frezat, rulet dhe brangat)
- Të shpjegojnë llojet e makinave shpërndarëse të plehut
- Të dallojnë makinat shpërndarëse të plehërave organike nga ato kimike
- Të shpjegojnë njohuritë themelore të makinave mbjellëse.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave mbjellëse me rrjeshta dhe të atyre me saktësi
- Të tregojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave mbjellëse të patateve dhe nguljes së fidaneve
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e kultivatorëve prashitës me kafshë dhe traktor, si dhe frezat prashitëse
- Të theksojnë rëndësinë ekonomike të ujitjes mekanike, si dhe ndërtimin dhe funksionimin e makinave shihedhëse
- Të shpjegojnë rëndësinë e trajtimeve kimike, mënyrat dhe tipet e makinave për mbrojtjen e bimëve
- Të përshkruajnë ndërtimin, përdorimin dhe vënien në punë të makinave me trysni
- Të shpjegojnë kontrollin, përgatitjen për punë dhe përdorimin e aparateve spërkatëse të shpinës
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe përdorimin e makinave spërkatëse pneumatike dhe hidropneumatike
- Të shpjegojnë sistemet e makinave sipas mënyrës së vjeljes dhe përdorimit të foragjereve
- Të shpjegojnë makinat kositëse të thjeshta, si dhe teknologjinë e kositjes
- Të rendisin makinat për tharjen dhe mbledhjen e barit, për ngjeshjen dhe lidhjen e sanës dhe kashtës

- Të dallojnë silazhimin nga senazhimin, si dhe të shpjegojnë makinat për korrjen dhe silazhimin e foragjereve
- Të rendisin mënyrat e korrjes, si dhe të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave korrëse e lidhëse
- Të theksojnë rolin e autokombajnave të të lashtave, si dhe të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e pjesëve të autokombajnës
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave për vjeljen e misrit
- Të spjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave pastruese, klasifikuese dhe tharëse të farës
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave për bluarjen dhe përpunimin e ushqimeve të blegtorisë
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e mjeteve për shpërndarjen e ushqimeve në stallë
- Të përshkruajnë pajisjet për furnizimin dhe pirjen automatike të ujit në stalla
- Të përshkruajnë makinat dhe pajisjet e hjeshta për pastrimin e stallave
- Të theksojnë rëndësinë e mjeljes mekanike të lopëve, si dhe të tregojnë teknikën me tre dhe dy takte (MM3, MM2)
- Të përshkruanë mekanizmat për përpunimin e qumështit (ftohësit, tundëset, skrematriçet, pasterizuesit)
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe përparësitë e qethjes mekanike të të imtat dhe si kryhet ajo.
- Të përshkruajnë shërbimet kryesore të mirëmbajtjes dhe riparimit të makinave bujqësore dhe blegtorale, si dhe rëndësinë e tyre.
- Të përshkruajnë strukturat që ofrojnë shërbimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit të makinave bujqësore dhe blegtorale.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e mekanikës bujqësore” kl. 11 - 68 orë**

| | | |
|----------------|---|-------|
| Tema 1 | Klasifikimi dhe përdorimet e makinave bujqësore dhe blegtorale | 3 orë |
| Tema 2 | Makinat për punimin bazë të tokës | 6 orë |
| Tema 3 | Makinat për punimin sipërfaqësor të tokës | 6 orë |
| Tema 4 | Makinat për shpërndarjen e plehërave | 3 orë |
| Tema 5 | Makinat mbjellëse | 6 orë |
| Tema 6 | Kultivatorët dhe frezat prashitëse | 3 orë |
| Tema 7 | Makinat për përmirësimin ujqor të tokës | 4 orë |
| Tema 8 | Makinat për mbrojtjen e bimëve | 6 orë |
| Tema 9 | Makinat për vjeljen dhe përpunimin e foragjereve | 8 orë |
| Tema 10 | Makinat për korrjen, shirjen dhe përpunimin e drithrave | 8 orë |
| Tema 11 | Makinat për përpunimin e ushqimeve të blegtorisë | 3 orë |
| Tema 12 | Mekanizimi i proceseve të punës në komplekset blegtorale | 8 orë |
| Tema 13 | Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të makinave bujqësore e blegtorale | 4 orë |

6. Lënda “Bimët e arave” (L-14-043-15) Kl. 10 – 72 orë

• **Synimet e lëndës ”Bimët e arave”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bimët e arave” në klasën 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe vlerat ekonomike dhe bujqësore të drithrave në ekonominë e një vendi.
- Të klasifikojnë dhe dallojnë drithërat e lashta nga të vonat sipas tipareve kryesore të tyre dalluese.
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe element të ushqyes të të lashtave (grurë, tërshërë, elb, thekër).
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të të lashtave sipas specifikave të tyre si dhe ruajtjen e prodhimit në depo.
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të misrit si përfaqësuesi kryesor i të vonave.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të misrit si dhe ruajtjen e prodhimit pas vjeljes në koçek apo mjedise të tjera.
- Të përshkruajnë përhapjen, rëndësinë, veçoritë dhe kërkesat për klimë tokë dhe element ushqyes të orizit.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe kultivarët e bishtajoreve për kokërr;
- Të identifikojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë e elementë ushqyes të kulturave bishtajore për kokërr si: fasulja, soja, qiçra, thjerrëza etj;
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të kulturave bishtajore;
- Të përshkruajnë vlerat ekonomike, bujqësore të kulturave industriale.
- Të klasifikojnë kulturat industriale sipas përdorimit të tyre në bujqësi apo industri.
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të pambukut.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të pambukut.
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të lulediellit.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të lulediellit.
- Të theksojnë rëndësinë e kultivimit dhe dëmet shëndetësore të përdorimit të duhanit.
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, cilësitë fiziko-kimike të gjetheve, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të duhanit.
- Të përshkruajnë përgatitjen e fidanëve të duhanit.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të duhanit.
- Të përshkruajnë mënyrat e manipulimit të duhanit.
- Të përshkruajnë përhapjen, rëndësinë e kultivimit, veçoritë dhe kërkesat për klimë, tokë element ushqyes dhe përdorimin e bimëve eterovajore;
- Të identifikojnë karakteristikat botanike dhe veçoritë biologjike të borzilokut, mendrës, lavandës, sherebelës, koriandrit dhe piretrumit;
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të bimëve eterovajore;
- Të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe klasifikimin e patates.
- Të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të patates.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të patates sipas zonave, si dhe rëndësinë e prodhimit të patates verore.
- Të identifikojnë sëmundjet, dëmtuesit dhe masat e luftimit të tyre.
- Të përcaktojnë mënyrat e vjeljes dhe ruajtjes së prodhimit të patates.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike dhe bujqësore të prodhimit të kulturave foragjere si bazë ushqimore për blegtorinë.
- Të rendisin veçoritë kryesore të prodhimit foragjer.
- Të përcaktojnë burimet e prodhimit foragjer si ushqim bazë për blegtorinë.

- Të përshkruajnë bimësinë e grupit të hasëlleve dhe tagjive sipas familjeve: gramore-misri, melakuqi, tërshëra , elbi, thekra etj., bishtajore- batha , bizelja foragjere, buxhaku, urovi, lupini, soja, tërfili aleksandrin etj., kryqore- lakra lululakra, kolza, perko.etj.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kulturave të grupit të hasëlleve dhe tagjive sipas grupit të familjeve.
- Të klasifikojnë livadhet sipas jetëgjatësisë , llojit të bimësisë dhe bashkëshoqërimit të tyre.
- Të përshkruajnë bimësinë e kulturave livadhore sipas familjeve : gramore- egjera, bisht miu, bishtpelëza, telishi, flokëzat, bromuset etj., bishtajore- jonxha, lloje të ndryshme tërfilesh esparceta , sulla etj.
- Të spjegojnë veçoritë e kultivimit të jonxhës , si një ndër kulturat më të rëndësishme të livadheve.
- Të përshkruajnë rëndësinë, klasifikimin , veçoritë dhe bimësinë e kullotës .
- Të përshkruajnë masat agroteknike që merren në përmirësimin e kullotës si dhe mënyrat e shfrytëzimit të tyre.
- Të përshkruajnë rëndësinë praktike dhe ekonomike të përdorimit të nënprodukteve të bujqësisë, blegtorisë dhe industrisë në ushqimin e kafshëve.
- Të përcaktojnë të gjitha llojet e nënprodukteve që përdoren në ushqimet e blegtorisë.
- Të përshkruajnë rëndësinë e përdorimit të nënprodukteve të bujqësisë e blegtorisë në blegtori;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bimët e arave”, kl. 10 - 72 orë**

| | | |
|----------------|---|-------|
| Tema 1 | Rëndësia, përhapja dhe klasifikimi i drithrave | 2 orë |
| Tema 2 | Karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të të lashtave | 4 orë |
| Tema 3 | Agroteknologjinë e kultivimit të të lashtave | 6 orë |
| Tema 4 | Karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të të vonave | 4 orë |
| Tema 5 | Agroteknologjinë e kultivimit të misrit | 5 orë |
| Tema 6 | Rëndësia, veçoritë dhe kërkesat për klimë tokë dhe element ushqyes të orizit. | 1 orë |
| Tema 7 | Bishtajorët për kokërr | 6 orë |
| Tema 8 | Pambuku | 2 orë |
| Tema 9 | Luledielli | 5 orë |
| Tema 10 | Duhani | 5 orë |
| Tema 11 | Panxhari | 2 orë |
| Tema 12 | Bimët eterovajore | 4 orë |
| Tema 13 | Rëndësia, përhapja dhe klasifikimi i patates | 2 orë |
| Tema 14 | Karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të patates | 3 orë |
| Tema 15 | Agroteknologjia e kultivimit të patates sipas zonave. Patatja verore | 3 orë |
| Tema 16 | Mënyrat e vjeljes dhe të ruajtjes së prodhimit të patates | 2 orë |
| Tema 17 | Rëndësia dhe veçoritë e prodhimit foragjer | 2 orë |
| Tema 18 | Hasëllet dhe tagjitë | 6 orë |
| Tema 19 | Livadhet dhe kullotat | 6 orë |
| Tema 20 | Nënprodhimet e bujqësisë dhe industrisë si ushqim foragjer | 2 orë |

7. Lënda “Pemët frutore” (L-14-044-15) Kl. 11 – 68 orë

• Synimet e lëndës ”Pemët frutore”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Pemët frutore” klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rolin dhe rëndësinë e pemëtarisë në kushtet klimatiko-tokësore të vendit tonë;
- Të klasifikojnë pemët frutore sipas ndërtimit të jashtëm të tyre;
- Të përshkruajnë karakteristikat morfologjike dhe veçoritë biologjike të drufrutorëve;
- Të përshkruajnë organet e rritjes dhe të zhvillimit të drufrutorëve;
- Të rendisin funksionet dhe ndërtimin e sistemit rrënjor të drufrutorëve;
- Të përshkruajnë rolin, ndërtimin dhe llojet e degëzave, gjetheve, sythave,
- Të përshkruajnë rolin, ndërtimin dhe llojet e luleve, frutave dhe farave të drufrutorëve;
- Të përshkruajnë zhvillimin individual të filizit dhe të fidanit, si dhe fazat nëpërmjet të cilave kalon ky zhvillim;
- Të përshkruajnë rëndësinë e njohjes së ciklit vjetor të rritjes dhe etapat e një cikli të plotë;
- Të përshkruajnë periudhën e vegjetacionit e të rritjes së lastarëve, periudhën e qetësisë dhe rëndësinë praktike të njohjes së saj;
- Të përshkruajnë rolin e mjedisit në jetën e pemëve frutore dhe faktorët klimatikë dhe tokësor.
- Të theksojnë kuptimin e prodhimit periodik të drufrutorëve dhe pse ndodh ai;
- Të analizojnë faktorët që favorizojnë prodhimin periodik;
- Të përcaktojnë rrugët e mënjanimin të prodhimit periodik;
- Të përshkruajnë faktorët klimatikë që ndikojnë në jetën e drufrutorëve;
- Të përshkruajnë faktorët tokësorë që ndikojnë në jetën e drufrutorëve ;
- Të theksojnë çfarë kuptojnë me rajonizim të kulturave drufrutore;
- Të rendisin kushtet për rajonizim e kulturave drufrutorëve;
- Të përshkruajnë mënyrat e shtimit të drufrutorëve;
- Të theksojnë kuptimin e shartimit dhe si realizohet ai;
- Të listojnë pajisjet, veglat me anë të të cilave realizohet shartimi;
- Të dallojnë mënyrat kryesore të shartimit të drufrutorëve, llojet dhe procedura e realizimit të tyre;
- Të përshkruajnë kriteret e përzgjedhjes kulturës për nënshartesë të pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve.
- Të përshkruajnë hallkat e teknologjisë së prodhimit të fidanit frutor: farishtja, fidanishtja, shartesorja I, II, III;
- Të përshkruajnë të gjitha etapat e krijimit të një pemtoreje;
- Të përshkruajnë agroteknikën e pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve që nga përgatitja e tokës deri te vjellja e prodhimit;
- Të përshkruajnë llojet dhe teknikat e krasitjes të pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve.
- Të theksojnë rolin dhe rëndësinë ekonomike të kultivimit të hardhisë në kushtet klimateriko-tokësore të vendit tonë;
- Të përshkruajnë veçoritë botanike dhe bazat biologjike të hardhisë.
- Të përshkruajnë veçoritë e krijimit të vreshtave të rinj;
- Të përshkruajnë zhvillimin individual të hardhisë;
- Të rendisin e përshkruajnë mënyrat e shtimit të hardhisë;
- Të analizojnë etapat e rritjes dhe prodhimit të hardhisë.
- Të përshkruajnë qëllimin, fazat dhe sistemet e krasitjes së hardhisë;

- Të përshkruajnë agroteknikën që zbatohet në vreshta, si dhe teknikat e vjeljes dhe ruajtjes së prodhimit të hardhisë;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pemët frutore” kl. 11 - 68 orë**

| | | |
|----------------|---|-------|
| Tema 1 | Roli, rëndësia dhe klasifikimi i drufrutorëve. | 2 orë |
| Tema 2 | Organet e rritjes, të zhvillimit dhe të riprodhimit të drufrutorëve | 5 orë |
| Tema 3 | Zhvillimi i drufrutorëve | 5 orë |
| Tema 4 | Roli i mjedisit në jetën e drufrutorëve. Rajonizimi i drufrutorëve | 2 orë |
| Tema 5 | Rëndësia e shtimit të drufrutorëve. Faktorët që ndikojnë në shtimin e tyre. | 2 orë |
| Tema 6 | Shtimi me farë i drufrutorëve | 2 orë |
| Tema 7 | Shtimi me copa i drufrutorëve | 5 orë |
| Tema 8 | Shartimi dhe rëndësia praktike e shtimit të drufrutorëve me shartim. | 2 orë |
| Tema 9 | Pajisjet, veglat dhe materialet e nevojshme për shartim | 2 orë |
| Tema 10 | Mënyrat e shtimit me shartim | 6 orë |
| Tema 11 | Hallkat teknologjike të prodhimit të fidanëve të pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve | 8 orë |
| Tema 12 | Krijimi i pemëtoreve të reja | 6 orë |
| Tema 13 | Agroteknika e pemëve frutore, ullirit dhe e agrumeve | 8 orë |
| Tema 14 | Baza e biologjisë dhe zhvillimi individual i hardhisë | 4 orë |
| Tema 15 | Shtimi i hardhisë. Krijimi i vreshtave të rinj | 6 orë |
| Tema 16 | Agroteknika e vreshtave | 4 orë |

8. Lënda “Bazat e veterinarisë” (L-19-045-09) Kl. 11 - 68 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e veterinarisë”, kl. 11 – 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e veterinarisë” klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë thelbin dhe natyrën e sëmundjes në përgjithësi.
- Të analizojnë shkaqet dhe faktorët që kushtëzojnë përhapjen e sëmundjes.
- Të dallojnë llojet e pezmatimeve në bazë të shenjave klinike.
- Të përshkruajnë mënyrën e kontrollit të përgjithshëm të kafshës.
- Të konstatojnë humbjet dhe dëmet ekonomike të shkaktuara nga sëmundjet.
- Të përshkruajnë mënyrat dhe metodat e parandalimit të sëmundjeve.
- Të përshkruajnë se si mjekohet një kafshë e sëmurë.
- Të të përshkruajnë se si mbahet dokumentacioni veterinar.
- Të përshkruajnë masat profilaktike të tilla si: dezinfektimi i stallës dhe i territorit përreth, vaksinimet, provat e diagnostikimit, etj.
- Të tregojnë metodat e egzaminimit për çdo aparat të kafshës.
- Të krahasojnë gjendjen normale dhe patologjike të kafshës pas kontrollit.
- Të tregojnë teknikat dhe metodat e fiksimit në kafshë të ndryshme.
- Të theksojnë mënyrat e ndryshme të injektimit të barnave në kafshë.
- Të grupojnë sëmundjet sipas aparateve në kafshë.
- Të theksojnë shenjat klinike për sëmundje të ndryshme.
- Të dallojnë sëmundjet infektive nga ato parazitare.
- Të dallojnë shenjat klinike në mastite.

– Të dallojnë shenjat klinike në pjelljet e vështira.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat veterinarisë”, kl. 11 – 68 orë**

| | | |
|----------------|---|-------|
| Tema 1 | Njohuri të përgjithshme për veterinarinë | 2 orë |
| Tema 2 | Koncepti mbi sëmundjen | 6 orë |
| Tema 3 | Pezmatimi dhe llojet e tij | 4 orë |
| Tema 4 | Njohuri të përgjithshme mbi autopsinë | 5 orë |
| Tema 5 | Infeksioni dhe qendresa e organizmit ndaj infeksionit | 8 orë |
| Tema 6 | Profilaksia e përgjithshme dhe e veçantë | 8 orë |
| Tema 7 | Metodat e përgjithshme të ekzaminimit | 4 orë |
| Tema 8 | Ekzaminimi i kafshës së sëmurë | 6 orë |
| Tema 9 | Metodat e fiksimit dhe injeksionet në kafshë | 6 orë |
| Tema 10 | Plagët kirurgjikale | 8 orë |
| Tema 11 | Sëmundjet ordinere në kafshët bujqësore | 4 orë |
| Tema 12 | Sëmundjet infektive dhe parazitare në kafshët bujqësore | 7 orë |

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli: “Marrja e mostrës së tokës për analizë”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 10

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|---|--|--------------|
| Titulli dhe Kodi | MARRJA E MOSTRËS SË TOKËS PËR ANALIZË | M-14-1133-15 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer punime të hapjes së profilin të tokës, marrjes së mostrës së profilin të tokës sipërfaqes së tokës bujqësore për analizë. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 36 orë mësimore (1kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi hap profilin dhe merr mostrën e tokës për analizë pedologjike. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglave të punës për marrjen e mostrës në profilin e tokës.– Transportimi i veglave të punës në vendin e duhur.– Zgjedhja e vendit ku do të hapet profili i tokës.– Piketimi i vendit për hapjen e profilin të tokës.– Teknika e hapjes së profilin në tre shtresat e saj.– Përcaktimi i shtresave të profilin të tokës.– Teknika e marrjes së mostrës në mesin dhe në të gjithë shtresën e çdo horizonti.– Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë hapjes së profilin dhe marrjes së mostrës së tokës për analizë pedologjike. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat e dorës për hapjen e profilin dhe marrjen e mostrës për analizë pedologjike;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës që do të përdoren; | |

- të përcaktojë vendin ku do të merret mostra sipas kritereve caktuara;
- të piketojë tokën për hapjen e profilin sipas parametrave të duhur;
- të hapë profilin e tokës në tre shtresat e saj;
- të përcaktojë shtresat e profilin sipas karakteristikave përkatëse;
- të marrë mostrën në mesin dhe në të gjithë shtresën e çdo horizonti;
- të përpunojë mostrën pas marrjes (shkrifërim, tharje) për ta përgatitur për analizë.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së profilin dhe marrjes së mostrës;

RM 2 Nxënësi merr mostrën në sipërfaqe të tokës për analizë agrokimike.

Permbajtja

- Teknika e hapjes së tokës në thellësinë e duhur.
- Teknika e konfigurimit të një drejtkëndëshi dhe diagonaleve të tij në tokë.
- Teknika e marrjes së mostrave në pika të ndryshme.
- Teknika e hapjes në letër dhe tharja e mostrave.
- Largimi i mbetjeve bimore nga mostrat.
- Teknika e përzierjes së mostrave.
- Teknika e nxjerrjes së mostrës mesatare me metodën e diagonaleve.
- Teknika e përpunimit të mostrës.
- Teknika e ambalazhimit dhe etiketimit të mostrës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë marrjes së mostrës në sipërfaqen e tokës për analizë agrokimike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hapë tokën në thellësinë nga 0 deri 30 cm;
- të konfigurujë një drejtkëndësh dhe diagonalet e tij në tokë;
- të marrë mostrat në pika të ndryshme;
- të hapë në letër dhe thajë mostrat;
- të largojë mbetjet bimore nga mostrat;
- të përziejë siç duhet mostrat;
- të nxjerrë mostrën mesatare me metodën e diagonaleve;
- të përpunojë me kujdes mostrën e tokës;
- të ambalazhojë dhe etiketojë me kujdes mostrën;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë marrjes së mostrës në sipërfaqen e tokës;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantët profesionale në parcelën pranë shkollës, në ferma bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punimeve të marrjes së mostrës së tokës për analizë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur veglat dhe pajisjet, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me punimet e marrjes së mostrës së tokës për analizë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për përdorimin e veglave dhe pajisjeve të dorës, si dhe për marrjen e mostrës së tokës për analizë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Parcelë për kryerjen e praktikës.
 - Vegla të thjeshta të dorës si: kazma, bel etj.
 - Uniforma e punës
 - Letër për vendosjen e mostrave.
 - Letër ambalazhi.
 - Etiketa.
 - Katalog e manuale të ndryshme në ndihmë të zbatimit të modulit.
-

2. Moduli: “Kultivimi i perimeve me fidanë”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kodi | KULTIVIMI I PERIMEVE ME FIDANË | M-14-744-11 |
|---|--|-------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të ndërtuar farishten, mbjellë farën e prodhuar fidanë në farishte, si dhe për të kultivuar perime të ndryshme me fidanë dhe për t’u përkujdesur gjatë rritjes së tyre. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 36 orë mësimore (1 kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi përgatit tokën për ngritjen e farishtes.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglat, pajisjeve për përgatitjen e tokës për ndërtimin e farishtes– Përcaktimi i tokës për ndërtimin e farishtes.– Transportimi i veglave, pajisjeve dhe materialeve në vendin e duhur.– Plehërimi organik dhe mineral.– Punimi bazë i tokës.– Punimet plotësuese të tokës.– Përgatitja e dherishtes.– Ndërtimi i vllajës.– Pastrimi i tokës nga gurët dhe mbeturinat e forta.– Kontrolli i cilësisë së punimeve.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për ngritjen e farishtes. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës për ngritjen e farishtes;– të përgatitë sipas nevojës materialet ndihmëse për ndërtimin e farishtes;– të përcaktojë sipërfaqen e tokës për ndërtimin e farishtes, sipas kriterëve të duhura;– të transportojë me krah veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur të shpërndajë me krah plehun organik dhe | |

-
- mineral sipas kritereve;
 - të shpërndajë plehun organik në sipërfaqen e tokës me krahë në sasinë e duhur;
 - të kryejë siç duhet punimi bazë i tokës me bel;
 - të kryejë shkrihimin e shtratit të mbjelljes me vegla dore;
 - të realizojë thërmimin e copave të vogla të tokës me dorë;
 - të kryejë ngritje e vllajës sipas parametrave teknik.
 - të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta;
 - të kryejë sheshimin dhe hedhjen e plehut të imët mbi vllajë sipas udhëzimeve;
 - të kryejë ujitjen paraprake nëse është e nevojshme;
 - të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve;
 - të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për ngritjen e farishtes.

RM 2 Nxënësi mbjell farën për prodhim fidanësh.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja farës për mbjellje.
- Përcaktimi i sasisë së farës për mbjellje.
- Dezinfektimi i farës para mbjelljes.
- Trajtimi paraprak i farës për mbjellje.
- Mbjellja e farës.
- Hedhja e shtresës së hollë të plehut organik të të imtave.
- Ngjeshja e lehtë e dheut pas mbjelljes.
- Ujitja pas mbjelljes.
- Plehërimi plotësues në farishte.
- Mbulimi i vllajës me materiale të ndryshme.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së fidanëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë farën sipas cilësisë së farës dhe llojit të kulturave perimore;
- të përcaktojë saktë sasinë e farës për mbjellje;
- të përcaktojë saktë kohën e mbjelljes së farës në farishte;
- të trajtojë para mbjelljes farën nëse është e nevojshme;
- të mbjellë farën në farishte sipas teknikës më të përshtatshme me specifikat sipas kulturave perimore;
- të ujisë farishten me shoshë pas mbjelljes së farës;
- të kryejë mbulimin e farishtes me materiale të ndryshme: politilen (PVC), rrogzë, etj.;
- të zbatojë me përpikëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së fidanëve perimor.

RM 3 Nxënësi kryen shërbimet pas mbjelljes në farishte.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave dhe materialeve për kryerjen e shërbimeve pas mbjelljes së farës në farishte.
- Ujitja pas mbjelljes së farës.
- Heqja e barërave të këqija.
- Rrallimi i bimëve.
- Plehërimi i lëngshëm.
- Spërkatjeve për mbrojtjen e bimëve.
- Kalitja e fidanëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve pas mbjelljes, në farishte.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve pas mbjelljes së farës në farishte.
- të kryejë ujitjen pas mbjelljes së farës me ujë të pastër dhe jo të ftohtë me shoshë.
- të heqë barërat e këqija;
- të kryejë rrallimet e bimëve duke respektuar distancat e duhura të mbjelljes;
- të kryejë plehërimin e lëngshëm duke mënjanuar djegien e gjetheve;
- të kryejë spërkatjen e fidanëve me lëng bordolez ose zinep sipas udhëzimeve të specialistit;
- të sigurojë ajrimin e farishtes;
- të përgatisë fidanin për kushtet të mjedisit të hapur;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve pas mbjelljes.

RM 4 Nxënësi përgatit tokën dhe fidanin për mbjellje.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për përgatitjen e tokës për mbjelljen e fidanëve.
- Përcaktimi i sipërfaqes për mbjelljen e fidanëve.
- Pastrimi i sipërfaqes nga objektet e forta.
- Plehërimi organik i tokës.
- Punimi bazë dhe plotësues i tokës.
- Piketimi i sipërfaqes së caktuar për mbjellje.
- Ujitja e rëndë e farishtes.
- Seleksionimi i fidanëve të shëndoshë
- Shkulja e fidanëve nga farishtja.
- Trajtimi i rrënjës së fidanëve të shkukur.
- Transporti i fidanëve në vendin e mbjelljes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së

mjedisit gjatë përgatitjes së tokës dhe fidanëve për mbjellje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e nevojshme për përgatitjen e tokës për mbjelljen e fidanëve në sera.
- të plehërojë tokën me plehra organo-minerale në dozën e duhur;
- të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës me krah;
- të piketojë rreshtat sipas parametrave dendësorë;
- të piketojë distancat e bimëve në rresht sipas kulturës perimore.
- të kryejë ujitjen e rëndë të farishtes një ditë para shkulljes.
- të kryejë seleksionimin e fidanëve të shëndoshë sipas treguesve cilësorë;
- të kryejë shkulljen e fidanëve nga farishtja pa dëmtuar sistemin rrënjor;
- të kryejë saktë banjëzimin e rrënjës së fidanëve të shkullur;
- të kryejë transportimin e fidanëve duke mbrojtur gjethet nga ndotja;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës së fidanëve perimor për mbjellje;

RM 5 Nxënësi mbjell fidanë në vendin e përhershëm.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e veglave për mbjelljen e fidanëve.
- Përcaktimi i mënyrës së mbjelljes së fidanëve.
- Hapja e gropës ose e brazdës për mbjellje.
- Vendosja e fidanëve nëpër grupa ose brazdë.
- Realizimi i mbjelljes së fidanëve.
- Ngjeshja e lehtë e tokës pas mbjelljes së fidanëve.
- Ujitja e lehtë pas mbjelljes.
- Prova për cilësinë e mbjelljes së fidanëve.
- Korrigjimi i mbjelljes së fidanëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së fidanëve në vendin e përhershëm.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe mjetet e duhura për mbjelljen e fidanëve;
- të përcaktojë mënyrën e mbjelljes së fidanëve sipas kulturave: me grupa, me kunj, me brazda etj.
- të hapë grupat ose brazdat sipas distancave të mbjelljes së

- kulturave perimore.
- të hapë vrimat për mbjelljen e fidanëve me kunj në distancat e piketuara më parë;
- të vendosë në gropa dhe brazda fidanët e shëndetshëm për tu mbjellë;
- të realizojë mbjelljen e fidanëve në gropa dhe brazda me cilësi;
- të kryejë kontrollin e cilësisë së mbjelljes së fidanëve;
- të kryejë korrigjimet e nevojshme në mbjelljen e fidanëve perimor;
- të zbatojë me përpikëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së fidanëve në vendin e përhershëm.

RM 4 Nxënësi kryen shërbimet kulturore pas mbjelljes së fidanëve, në vendin e përhershëm.

Përmbajtja

- Kontrolli i zënies së fidanëve të mbjellë.
- Zëvendësimi i vende bosh me fidanë të rinj.
- Ujitja e lehtë pas mbjelljes së fidanëve.
- Vendosja e sistemit mbështetës për fidanët.
- Lidhja e fidanëve me sistemin mbështetës.
- Prashitja dhe mbathja e fidanëve.
- Heqja e gjetheve të tepërta.
- Ujitja e fidanëve të mbjellë.
- Plehërimet plotësuese.
- Shërbimet specifike për kultura specifike perimore.
- Spërkatja e fidanëve.
- Kontrolli i vazhdueshëm i rritjes ë bimëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve kulturore pas mbjelljes së fidanëve perimor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë kontrollin e zënies së fidanëve në bazë simptomave të tyre;
- të bëjë zëvendësimin e fidanëve të pazënë me fidanë të rinj;
- të bëjë ujitje të lehtë pas mbjelljes së fidanëve nëse është e nevojshme;
- të vendosë sistemin e mbështetjes për kulturat perimore përkatëse si domatja, kastravec, kungulli, etj.
- të lidhë me kujdes bimën poshtë gjethes së fundit me sistemin mbështetës të saj;
- të kryejë prashitjen dhe mbathjen e bimëve sipas specifikave të tyre;
- të përdorë pajisjet thjeshta për ujitjen e bimëve në mjedis

- të mbrojtura dhe fushë të hapur;
- të heqë sjetullorët te kulturat përkatëse;
- të bëjë këputjen e majës në momentin e duhur;
- të kryejë heqjen e gjetheve të panevojshme të kateve të para;
- të kryejë edhe krasitje të gjelbërt kur është e nevojshme sipas kulturave perimore;
- të kryejë operacione pune për spërkatje me pompë për mbrojtjen e bimëve nga sëmundje dhe dëmtues të ndryshëm, sipas udhëzimeve të specialistit;
- të verë në punë paisjet e kontrollit për të ruajtur temperaturën, lagështirën dhe ajrimin e duhur;
- të kontrollojë rritjen e bimëve për të përcaktuar kohën e pjekjes;
- të zbatojë me përpikëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve kulturore pas mbjelljes së fidanëve.

RM 5 Nxënësi vjel prodhimin perimor me krah.

Përmbajtja

- Sigurimi i bazës materiale të nevojshme.
- Përgatitja e mjediseve për ruajtjen e prodhimeve.
- Përcaktimi i kohës së pjekjes së prodhimit.
- Vjelja me dorë prodhimin perimor.
- Vendosja e prodhimin të vjelë në arkë.
- Klasifikimi i prodhimin të perimeve.
- Ambalazhimi i prodhimin perimor.
- Transportimi i prodhimin të perimeve.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë vjeljes dhe grumbullimit të prodhimin perimor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sigurojë bazën materiale të nevojshme; arka, thasë, kosha, litar etj;
- të përgatitë mjedise për ruajtjen e prodhimin perimor sipas parametrave specifike të tyre;
- të përcaktojë kohën e pjekjes së prodhimin perimor sipas drejtimit të prodhimin;
- të vjelë me dorë prodhimet perimore sipas specifikave të kulturave perimore;
- të vendosë prodhimet perimore nëpër arka me shumë kujdes;
- të klasifikojë prodhimet perimore sipas llojit të kulturës dhe standardit përkatës;
- të amballozhojë prodhimet sipas kërkesës së tregut;
- të transportojë, me krahë ose mjete të thjeshta transporti, prodhimet perimore në magazinë;

- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë vjeljes, grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimit perimor;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës (mjedise të mbrojtura ose fushë e hapur), në ekonomi bujqësore ku kultivohen perime me fidanë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përgatitjen e farishtes, dherishtes, përgatitjes së fidanit, shërbimeve pas mbjelljes së farës, mbjelljes së fidanëve në serë shërbimeve të ndryshme gjatë rritjes në serë apo fushë të hapur, vjeljes, paketimeve, dhe ruajtjes së prodhimit të vjelë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e një sërë operacionesh pune dhe shërbime të ndryshme për kultivimin e perimeve me fidanë të ndryshme fillimisht në mënyrë të mbikqyrur e më pas në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit, nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës e shërbimet e ndryshme në kulturat perimore që kryhen para. gjatë dhe pas mbjelljes së fidanit në vendin e përhershëm.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve e shërbimeve agroteknike që kërkohen para, gjatë dhe pas kultivimit të perimeve me fidanë.
- Mësuesi/Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në kultivues të suksesshëm të perimeve si në mjedise të mbrojtura edhe në fushë të hapur.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjetet e mëposhtme:
- Farëra perimesh të ndryshme..
 - Vegla të thjeshta dore.
 - Mjete për mbështetje dhe lidhëse.
 - Pompa spërkatëse.
 - Plehra kimike, pesticide, dherishte, pleh organik etj.
 - Pajisje ambalazhi, arka, kuti, etiketa, etj.
 - Mjedis i mbrojtur dhe i hapur i përshtatshëm.
 - Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë etj.
-

3. Moduli “Kujdesi për kafshët bujqësore”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kodi | KUJDESI PËR KAFSHËT BUJQËSORE | M-28-1134-15 |
|--|--|--------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer procese pune për pastrimin e lëkurës së trupit të kafshës, shërbime higjienike dhe klimatike në stallë, procese pune për të përgatitur ushqimet, zbatuar metodat e të ushqyerit të kafshëve, si dhe për tu kujdesur për kafshët bujqësore në ferma blegtorale. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 54 orë mësimore (1,5 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi pastron lëkurën e trupit të kafshës Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e uniformës për pastrimin e lëkurës së trupit të kafshëve.– Zgjedhja e mjeteve dhe paisjeve që përdoren për pastrimin e trupit të kafshës.– Teknika e pastrimit të lëkurës së kokës së kafshës.– Teknika e pastrimit të lëkurës së gjymtyrëve të përparme të kafshës.– Teknika e pastrimit të lëkurës së gjymtyrëve të pasme të kafshës.– Teknika e pastrimit të lëkurës së shtyllës kurrizore dhe të barkut të kafshës.– Larja dhe dezinfektimi i duarve pas pastrimit të lëkurës së kafshëve.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të lëkurës së kafshëve bujqësore. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të zgjedhë saktë mjetet dhe paisjet që përdoren për pastrimin e trupit të kafshës nga dëmtuesit dhe parazitët e lëkurës së kafshëve;– të veshë uniformën për të kryer pastrimin e lëkurës së kafshës nga parazitët dhe dëmtuesit e saj;– të kryejë pastrimin e lëkurës së kokës së kafshës sipas | |

-
- teknikës përkatëse.
 - të kryejë pastrimin e lëkurës së gjymtyrëve të përparme të kafshës sipas teknikës përkatëse.
 - të kryejë pastrimin e lëkurës së gjymtyrëve të pasme të kafshës sipas teknikës përkatëse.
 - të kryejë pastrimin e lëkurës së pjesës kryesore të kafshës sipas teknikës përkatëse.
 - të lajë dhe dezinfektojë duart pas pastrimit të lëkurës së kafshëve.
 - të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbajtjes së higjienës së lëkurës së trupit të kafshës.

RM 2 Nxënësi kryen pastrimin e gjirit të kafshës.

Përmbajtja

- Përcaktimi i radhës së punës për higjienën e gjirit.
- Përzgjedhja e mjeteve për pastrimin e gjirit
- Përgatitja e mjeteve për pastrimin e gjirit.
- Heqja mekanike e papastërtive të gjirit të kafshës.
- Larja e gjirit.
- Masazhimi i gjirit.
- Mbajtja e shënimeve të punëve të kryera.
- Zbatimi i masave të sigurimit teknik gjatë punës për pastrimin dhe larjen e gjirit.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të rendisë sipas radhës së punës proceset për pastrimin dhe larjen e gjirit.
- të përzgjedhë saktë mjetet që nevojiten për pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit.
- të përgatitë siç duhet mjetet që nevojiten për pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit.
- të bëjë pastrimin e lehtë mekanik për të hequr papastërtitë e ndryshme në gjirin e kafshës.
- të bëjë larjen e gjirit me pece dhe ujë të ngrohtë.
- të bëjë masazhimin e gjirit me pece dhe ujë të ngrohtë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të gjirit
- të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- të zbatojë drejt masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për pastrimin dhe larjen e gjirit.

RM 3 Nxënësi kryen shërbime higjienike dhe klimatike në stallë.

Përmbajtja

- Përgatitja e veglave dhe e mjeteve për largimin e plehut organik nga stalla.

- Përcaktimi i vendit për grumbullimin e mbeturinave organike.
- Pastrimi i vendit të hedhjes së plehut.
- Dezinfektimi i vendit të hedhjes së plehut.
- Largimi i plehut organik nga stalla.
- Transportimi i plehut organik për në plehërishte.
- Grumbullimi i urinës në depozita të posaçme.
- Hapja e dritareve për ajrimin e stallës.
- Mirëmbajtja e veglave dhe pajisjeve që përdoren për heqjen e mbeturinave organike.
- Regjistrimi i operacioneve të kryera.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë largimit të mbeturinave në stallë.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë veglat dhe mjetet për largimin e plehut organik nga stalla.
- të largojë në kohën e duhur plehun nga stalla.
- të bëjë pastrimin e vendin e hedhjes së plehut për ruajtjen e mjedisit.
- të dezinfektojë vendin e hedhjes së plehut për ruajtjen e mjedisit.
- të transportojë në kohë dhe me mjetet e duhura plehun organik për në plehërishte.
- të bëjë grumbullimin e urinës në depozita të posaçme.
- të trajtojë urinën e grumbulluar në çisternë.
- të hapë dritaret për ajrimin e stallës.
- të mirëmbajë e veglat dhe pajisjet për heqjen e mbeturinave organike.
- të bëjë regjistrim të saktë të operacioneve të kryera.
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik në punë gjatë largimit të mbeturinave në stallë.

RM 4 Nxënësi kryen dezinfektimin e stallave dhe territoreve të fermës.

Përmbajtja

- Përcaktimi i mënyrës së dezinfektimit.
- Teknika e përdorimit të pluhurit të gëlqeres për dezinfektimin e dyshemeve të stallave.
- Teknika e përdorimit të pompës spërkatëse ose pluhurosëse për dezinfektimin kimik.
- Teknika e zhytjes në tretësirën dezinfektuese e veglave e materialeve.
- Teknika e larjes me tretësirë, me fërkim lokalet, dyshemetë, dyertë, grazhdet, koritat e ujit, etj.

- Teknika e dezinfektimit të stallës, me djegie në sipërfaqe të kufizuara.
- Teknika e dezinfektimit me djegie vendin e ngordhjes së kafshëve me sëmundje ngjitëse.
- Largimi i mbeturinave.
- Shtrimi pas dezinfektimit, në stalla.
- Pastrimi i veglave, pajisjeve pas punës.
- Mbajtja e evidencave dhe regjistrimet përkatëse të operacioneve që kryhen.
- Zbatimi i masave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë dezinfektimit të stallave dhe territoreve të fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë pluhur gëlqere në dyshtim të stallës.
- të mbushë në nivelin e duhur pompën spërkatëse ose pluhurosëse me dezinfektantë kimik.
- të spërkasë ose të pluhurosë me kujdes stallën dhe territorin përreth.
- të zhysë në tretësirë dezinfektues materialet, si kova, vegla pastrimi të kafshëve, zinxhirët, etj.
- të lajë me fërkim me tretësirë lokalet, dyshtimet, dyertë, grazhdet, koritat e ujit, etj.
- të përdorë flakëhedhësen në dezinfektimin me djegie në sipërfaqe të kufizuara të stallës.
- të dezinfektojë me djegie vendin e ngordhjes së kafshëve me sëmundje ngjitëse.
- të dezinfektojë me djegie objekte dhe materiale që nuk digjen.
- të largojë mbeturinat dhe pastrojë ambientin sipas parametrave të kërkuara higjienike.
- të shtrojë, pas dezinfektimit në stallat me çimento, shtresa e re për kafshët, me tallash dhe kashtë.
- të pastrojë si veglat dhe pajisjet pas punës.
- të kryejë pastrimin vetjak pas punës.
- të marrë masat për sigurimin e territorit pas dezinfektimit.
- të bëjë një regjistrim të saktë të operacioneve të kryera.
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të metodave të ndryshme për dezinfektimin e stallave dhe territoreve të fermës.

RM 5 Nxënësi ushqen kafshët me regjim stallor në fermë.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e veglave për të realizuar ushqyerjen e kafshëve me regjim stallor.
- Përzgjedhja e llojit të ushqimit.
- Kontrolli paraprak organoleptik i ushqimit.

- Pastrimi i grazhdit për vendosjen e ushqimit.
- Përpunimi i ushqimeve në punishten e ushqimeve.
- Transportimi i ushqimeve nga depoja apo magazina për në ambientin e stallës.
- Ndarja racionale e ushqimit për krerë.
- Hedhja e ushqimit të racionuar në grazhd.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të kafshëve shtëpiake.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat e nevojshme të punës për të ushqyer kafshët bujqësore;
- të përzgjedhë llojin e ushqimit sipas llojit dhe nevojës së kafshës me regjim stallor;
- të bëjë pastrimin e grazhdit përpara hedhjes së ushqimit;
- të bëjë përpunimin paraprak të ushqimeve: copëtimin, lagjen etj, për kafshët bujqësore, në varësi të llojit të ushqimit;
- të kontrollojë cilësisë e ushqimeve të magazinuara me anë të prekjes, nuhatjes dhe dallimit të ngjyrës së ushqimeve;
- të transportojë ushqimet nga magazina në stallë me krah ose mjete të tjera të thjeshta sipas llojit të ushqimit;
- të bëjë ndarjen racionale të ushqimit për krerë bazuar në mos dhe drejtimin e mbarështimit të tyre;
- të realizojë vendosjen e ushqimeve në vendin e caktuar për ngrënie (grazhd);
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të kafshëve bujqësore në fermë.

RM 6 Nxënësi kryen kullotjen e lirë të kafshëve bujqësore në fermë.

Përmbajtja

- Përcaktimi i territorit ku do të kullotin kafshët bujqësore të fermës.
- Përgatitja e mjedisit për kullotjen e kafshëve shtëpiake.
- Përgatitja e kafshëve për kullotje.
- Lëshimi i kafshëve në fushë të hapur.
- Të ushqyerit e kafshëve me kalime në kullotë.
- Përdorimi i gardheve elektrike dhe pengesave në kullotë për kullotjen e lirë të kafshëve.
- Ndalimi i kafshëve në vendin më të përshtatshëm për kullotje.
- Ruajtja e kafshëve në fushë të hapur.
- Kthimi i kafshëve në fermë.
- Rregullat e sigurisë në punë dhe ruajtja e mjedisit gjatë kullotjes së kafshëve bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë territorin e duhur për kullotjen e kafshëve bujqësore;
- të përgatitë mjedisin për kullotjen e kafshëve shtëpiake;
- të përgatitë kafshët për daljen në kullotë;
- të ushqejë kafshët me kalime, sipas një praktike pozitive fermere;
- të realizojë kullotjen e lirë të kafshëve;
- të përdorë gardhet elektrike dhe pengesave të tjera në kullotë, kur është e nevojshme;
- të ndalojë kafshët në vendin më të përshtatshëm për kullotje;
- të kujdeset për kafshët në fushë të hapur;
- të kthejë shëndosh e mirë kafshët në fermë;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të kafshëve në kullotë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës, në stallë, ose të organizohen vizita mësimore ne ferma blegtorale pranë rajonit ku ndodhet shkolla.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për higjienën e trupit të kafshëve dhe të ushqyerit të tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për mënyrat e mbajtjes së higjienës së kafshëve dhe të ushqyerit të tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për përdorimin sa më të mirë të veglave të punës, instrumentave dhe pajisjeve në një fermë blegtorale.
- Mësuesi/instruktori mund të organizohen edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë blegtorinë me regjim stallor.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të të ushqyerit të kafshëve në metoda të ndryshme dhe të ruajtjes së higjienës ë tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përzgjedhjen e ushqimeve, transportimin e tyre në stallë, si dhe për realizimin e të ushqyerit të kafshëve me regjim stallor apo kullotje të lirë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve.
 - Plehërishtë dhe depozitë të urinës.
 - Makineri, pajisje dhe vegla të punës për largimin e plehut.
 - Krehër druri, furça, sfungjerë, thika të drunjta
 - Maket gjiri, peshqire, pece, kova uji.
 - Dezinfektant kimik (kreolinë, sodë kaustike, klor, etj).
 - Gëlqere.
 - Pompa spërkatëse, pluhurose, flakëdhënëse.
 - Komplete veshje pune për dezinfektim.
 - Tokë kullosore.
 - Magazinë ushqimi.
 - Depo silazhi.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Tabela për nevojat ushqimore të kafshëve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Manuale praktike për të ushqyerin e kafshëve.
 - Katalogje ushqimesh etj
-

4. Moduli “Kultivimi i grurit”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kodi | KULTIVIMI I GRURIT | M-14-137-15 |
|---|---|-------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer përgatitjen e tokës, mbjelljen e farës, shërbimet agroteknike si dhe korrijen e prodhimit të grurit. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 54 orë mësimore (1,5 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi përgatit tokën për mbjellje.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglave dhe materialeve të punës për punimin bazë dhe plotësues të tokës.– Kontrolli fizik i veglave të punës.– Transportimi i veglave të punës.– Përcaktimi i parcelës për përgatitjen e tokës për mbjellje.– Piketimi i parcelës.– Pastrimi i parcelës nga gurët dhe mbeturina të tjera të forta.– Shpërndarja e plehrave organike në sipërfaqe të tokës– Punimi i thellë i tokës me vegla dore.– Punimet plotësuese të tokës.– Hapja e vijave kulluese.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës ër mbjellje. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat e duhura të punës për përgatitjen e tokës për mbjelljen e të lashtave;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës;– të caktojë vendin për përgatitjen e tokës për mbjellje, sipas parabimës, përbërjes mekanike të tokës;– të pastrojë parcelën nga gurët dhe mbeturina të tjera të forta;– të shpërndajë plehrat organike e minerale sipas nevojës së kulturës; | |

-
- të kryjë punimin e thellë të tokës me vegla dore duke respektuar mënyrat, kohën dhe thellësinë e kërkuar;
 - të kryejë punimet plotësuese të tokës deri në përgatitjen e shtratit të mbjelljes duke përdorur veglat e dorës në varësi të llojit të punimit, kohës dhe thellësisë së kryerjes së tyre;
 - të hapë vijat kulluese sipas parametrave të caktuara;
 - të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për mbjellje;

RM 2 Nxënësi hedh me dorë farën e grurit për mbjellje.

Përmbajtja

- Zgjedhja e farës për mbjellje.
- Dezinfektimi i farës para mbjelljes.
- Piketimi i parcelës në rreshta.
- Hapja e vijave mbjellëse.
- Hedhja me dorë zinxhir pa shpëputje e farës së grurit.
- Mbulimi i farës me dhe.
- Ngjeshja e lehtë e tokës pas mbjelljes së farës.
- Ujitja së tokës pas mbjelljes.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë hedhjes me dorë të farës së grurit për mbjellje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë farën sipas standardit të kërkuar;
- të dezinfektojë farën para mbjelljes me dezinfektantin e duhur;
- të piketojë rreshtat për mbjellje sipas largësive midis tyre të përcaktuara më parë;
- të hapë vijat mbjellëse me vegla dore, duke respektuar distancat e mbjelljes;
- të kryejë mbjelljen e farës zinxhir pa shpëputje me dorë duke respektuar, kohën e mbjelljes, sasinë e farës, thellësinë e mbjelljes sipas zonës dhe llojit të kultivarit;
- të mbulojë farën me dhe sipas udhëzimeve;
- të kryejë ngjeshjen e lehtë të tokës pas mbjelljes;
- të kryejë ujitjen menjëherë pas mbjelljes nëse është e nevojshme;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes me dorë të farës së grurit.

RM 3 Nxënësi kryen shërbimet agroteknike gjatë rritjes së grurit.

Përmbajtja

- Mirëmbajtja e vija kulluese.
- Capitja e tokës së mbjellë.
- Kryerja e prashitjes së lehtë deri në ngritjen e bimëve.

- Heqja e barërave të këqija.
- Kryerja e plehërimeve plotësuese.
- Kryerja e ujitjes.
- Zbatimi i masave agroteknike kundër rrëzimit të bimëve.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të ndryshme në parcelën e mbjellë me grurë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë në gjendje të mirë vijat kulluese në vazhdimësi;
- të kryejë capitjen e tokës në varësi të fazave të zhvillimit të bimës në thellësinë e duhur;
- të kryejë prashitjen e lehtë të bimëve me shat të ngushtë, në varësi të faza të zhvillimit në kohë të kufizuar (deri në ngritjen e tyre);
- të shkulë barërat e këqija në varësi të shkallës së infeksionit me dorë ose me masa agroteknike;
- të kryejë plehërimet plotësuese me plehra azotike në varësi të fazave të zhvillimit dhe vatrave me bimësi më të dobët, sipas udhëzimeve
- të kryejë ujitje nëse është e nevojshme në varësi të kushteve të motit;
- të zbatojë masa agroteknike kundër rrëzimit të bimëve;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike gjatë rritjes së bimëve të grurit në parcelë;

RM 4 Nxënësi korr prodhimin e grurit me krah.

Përmbajtja

- Përcaktimi i fazës së pjekjes.
- Kryerja e korrjes me dorë/krah e prodhimit të grurit.
- Grumbullimi i duajve.
- Kryerja e lidhjes së duajve.
- Lënia e duajve ë parcelë për largimin e lagështirës bimore.
- Transporti i duajve në vendin e shirjes.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë korrjes me dorë/krah të prodhimit të të lashtave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë fazën e pjekjes: përfundimi i pjekjes së dyllit;
- të realizojë korrjen e prodhimit duke respektuar teknikën e korrjes me dorë me drapër ose lelek etj;
- të grumbullojë duajt me qëndrim në këmbë;
- të lidhë duajt në peshën jo më shumë se 5 kg;

- të lërë në parcelë duajt jo më shumë se 2 ditë në parcelë për largimin e lagështirë së tepërt;
- të transportojë me krahë duajt në vendin e shirjes duke mënjanuar frot;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë korrjes me dorë/krah të të lashtave;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin enxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në parcelat pranë shkollës ose në ferma të ndryshme bujqësore ku kultivohet gruri apo kultura të ngjashme me të.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të përgatitjes së shtratit të mbjelljes dhe mbjelljes së farës me dorë, të kryerjes së shërbimeve kulturore dhe vjeljes së prodhimit të grurit apo kulturave të ngjashme me to.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e shtratit të mbjelljes, mbjelljen e farës me dorë dhe kryerjen e shërbimeve kulturore, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për përgatitjen e shtratit të mbjelljes me dorë, mbjelljen e farës, kryerjen e shërbimeve kulturore dhe korrjes së grurit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përgatitjen e shtratit të mbjelljes me dorë, mbjelljen e farës dhe kryerjen e shërbimeve kulturore dhe korrjes së prodhimit të grurit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Parcela ku do të kryhet mbjellja
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme.
 - Uniforma e veshjes,
 - Plehra organike.
 - Plehra kimike.
 - Drapër ose lelek.
 - Plasmas për transportimin e prodhimit.
 - Lidhëse për lidhjen e duajve.
 - Tezga dhe karroca dore.
 - Manuale e katalogje.
-

5. Moduli “Kultivimi i misrit”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kod | KULTIVIMI I MISRIT | M-14-138-11 |
|--|--|-------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përgatitjen e tokës, mbjelljen e farës së misrit, kryerjen e shërbimeve agroteknike si dhe vjeljen e prodhimit të misrit. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 51 orë mësimore (1.5 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi përgatit tokën për mbjelljen e misrit.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglave, materialeve apo makinerive të punës për përgatitjen e tokës për mbjelljen e misrit.– Kontrolli fizik i veglave, materialeve e makinerive të punës– Transportimi i veglave, materialeve apo makinerive të punës.– Përcaktimi i parcelës për përgatitjen e tokës për mbjellje.– Pastrimi i parcelës nga gurët e mbeturina të tjera të forta.– Shpërndarja e plehrave organike në sipërfaqe të tokës– Punimi bazë i tokës.– Punime plotësuese të tokës.– Hapja e vijave kulluese dhe ujitëse.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës, për mbjelljen e misrit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë veglat dhe materialet e duhura të punës për përgatitjen e tokës për mbjelljen e misrit: bel, kazëm, plehra organike, tezga etj., si dhe makineritë e duhura në rastet e kryerjes së punimeve të mekanizuara;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave, materialeve dhe makinerive të punës;– të caktojë vendin për përgatitjen e tokës për mbjellje: sipas parabimës, përbërjes mekanike të tokës;– të pastrojë parcelën nga gurët e mbeturina të tjera të forta.– të shpërndajë plehrat organike e minerale sipas nevojës së | |

-
- kulturës;
 - të kryjë punimin e thellë të tokës duke respektuar mënyrat, kohën dhe thellësinë e kërkuar;
 - të kryjë punimet plotësuese të tokës deri në përgatitjen e shtratit të mbjelljes, në varësi të llojit të punimit, kohës dhe thellësisë së kryerjes së tyre;
 - të hapë vijat kulluese dhe ujitëse sipas parametrave të caktuara;
 - të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës me krah, për mbjelljen e misrit;

RM 2 Nxënësi kryen mbjelljen e misrit.

Përmbajtja

- Zgjedhja e farës për mbjellje.
- Dezinfektimi i farës para mbjelljes.
- Piketimi i parcelës në rreshta.
- Hapja e vijave ose gropave mbjellëse.
- Mbjellja e farës së misrit.
- Mbulimi i farës me dhe.
- Ngjeshja e lehtë e tokës pas mbjelljes së farës.
- Ujitja e lehtë e tokës pas mbjelljes.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë kryerjes së mbjelljes së misrit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë farën sipas standardit të kërkuar;
- të dezinfektojë farën para mbjelljes me dezinfektantin e duhur;
- të kryejë hapjen e vijave mbjellëse sipas udhëzimeve përkatëse;
- të piketojë rreshtat për mbjellje sipas largësive midis tyre të përcaktuara më parë;
- të hapë vijat ose gropat mbjellëse, me krah apo të mekanizuar duke respektuar distancat e mbjelljes;
- të hedhë farën e misrit në vijat e hapura zinxhir me shkëputje duke respektuar, kohën e mbjelljes, sasinë e farës, thellësinë e mbjelljes sipas zonës e llojit të kultivarit;
- të mbulojë farën me dhë, sipas udhëzimeve;
- të kryejë ngjeshjen e lehtë të tokës pas mbjelljes;
- të kryejë ujitjen e lehtë menjëherë pas mbjelljes nëse është e nevojshme;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së mbjelljes së misrit;

RM 3 Nxënësi kryen shërbimet agroteknike tek kultura e misrit.

Përmbajtja

- Prishja e kores së tokës pas mbjelljes.
- Plotësimi i vendeve bosh.
- Rrallimi i bimëve të misrit.
- Prashitja e bimëve të misrit.
- Mbushja e bimëve së misrit.
- Ujitja e bimëve të misrit.
- Plehërimi plotësues i misrit.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike të kultura e misrit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të prishë koren e tokës në fazën e 2-3 gjetheve të vërteta deri në gjethen e pestë;
- të plotësojë vendet bosh me farë të lagur ose fidanë në fazën e 2-3 gjetheve të para;
- të kryejë rrallimin e bimëve të misrit duke respektuar distancat e mbjelljes dhe duke siguruar numrin e bimëve për hektar;
- të prashitë bimët e misrit gjatë gjithë ciklit vjetor deri në vjelje duke iu referuar gjendjes së tokës dhe shkallës së infeksionit të barërave të këqija;
- të bëjë mbushjen e bimës deri në nyjën e parë me dhe, nëse toka ka lagështirën e nevojshme;
- të ujisë bimët e misrit sa herë që bima ka nevojë në varësi të fazave të zhvillimit në varësi të sasisë dhe cilësisë së ujit;
- të kryejë plehërimin plotësues me plehra kimike në varësi të sasisë dhe llojit të plehut e fazave të zhvillimit të bimës;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike gjatë rritjes së bimëve të misrit;

RM 4 Nxënësi vjel/korr prodhimin e misrit.

Përmbajtja

- Përcaktimi i fazës së pjekjes.
- Vjelja/korrja e prodhimit të misrit.
- Largimi i prodhimit nga parcela.
- Grumbullimi i prodhimit.
- Zhveshja e kallirit me dorë nga lëpushkat.
- Largimi i lëpushkave nga vendi i zhveshjes së kallinjve.
- Vendosja e kallinjve të misrit në një mjedis të ajrosur.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë korrjes me dorë të prodhimit të misrit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë fazën e pjekjes: përfundimi i pjekjes së dyllit;
- të realizojë vjeljen/korrjen e prodhimit duke bërë shkëputjen e kallirit të veshur nga bima ose memmetoda të tjera;
- të grumbullojë prodhimin e vjelë sipas udhëzimeve;
- të zhveshë kallirin nga lëpushkat me kujdes;
- të largojë lëpushkat në një vend të përshtatshëm për blegtorinë;
- të vendosë prodhimin e misrit në një mjedis të ajrosur për tharje të mëtejshme;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të vjeljes së misrit;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional në parcelat pranë shkollës ose në ferma të ndryshme bujqësore ku kultivohet misri.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të përgatitjes së shtratit të mbjelljes, mbjelljes së farës, kryerjes së shërbimeve kulturore dhe vjeljes së prodhimit të misrit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e shtratit të mbjelljes, mbjelljen e farës dhe kryerjen e shërbimeve kulturore tek misri, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për përgatitjen e shtratit të mbjelljes, mbjelljen e farës, kryerjen e shërbimeve kulturore dhe vjeljes së misrit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përgatitjen e shtratit të mbjelljes, mbjelljen e farës dhe kryerjen e shërbimeve kulturore dhe vjeljes së prodhimit të misrit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Parcela ku do të kryhet mbjellja
 - Komploti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme.
 - Uniforma e veshjes, plehra organike, plehra kimike.
 - Drapër ose lelek, thasë për transportimin e prodhimit.
 - Mjete te mekanizuara për korrje
 - Tezga dhe karroca dore.
 - Manuale e katalogje.
-

6. Moduli “Drejtimi dhe përdorimi i traktorit me rrota”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kod | DREJTIMI DHE PËRDORIMI I TRAKTORIT ME RROTA | M-04-1135-15 |
|---|--|--------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për drejtimin para, mbrapa dhe në kthesa të traktorit me rrota, si dhe për të manovruar traktorin me rrota me rimorkio dhe makina të tjera bujqësore. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 85 orë mësimore (2.5 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit mësimor “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi kryen lëvizje para-mbrapa me traktor me rrota.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Hipja dhe zbritja nga traktori me rrota.– Pozicionimi në ndenjësen e traktorit.– Ndezja e traktorit.– Kontrolli i treguesve në kroskotin e traktorit.– Dhënia e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor.– Nisja e traktorit nga vendi për ecjen para në rrugë horizontale.– Lëvizja para me traktor me marshin e parë.– Ndalimi, sigurimi me frenin e dorës dhe fikja e traktorit në vend.– Nisja e traktorit nga vendi për ecjen para në rrugë të përpjetë.– Lëvizja mbrapa me traktor.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë kryerjes së lëvizjeve me traktor me rrota. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të realizojë hipjen dhe zbritjen nga traktori me rrota sipas udhëzimeve;– të pozicionohet në ndenjësen e traktorit sipas rregullave të përcaktuara;– të kryejë ndezjen e traktorit sipas udhëzimeve teknike; | |

- të kontrollojë treguesit në kroskotin e traktorit përpara nisjes;
- të realizojë në momentin e duhur dhënien e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor;
- të zbatojë procedurën e nisjes së traktorit nga vendi për ecjen para në rrugë horizontale, pa kolpo;
- të lëvizë para me traktor me marshin e parë;
- të realizojë ndalimin, sigurimin me frenin e dorës dhe fikjen e traktorit në vend sipas procedurës teknike.
- të zbatojë procedurën e nisjes së traktorit nga vendi për ecjen para në rrugë të përpjetë sipas hapave përcaktues.
- të lëvizë mbrapa me traktor sipas procedurës teknike.
- të realizojë ndalimin, sigurimin me frenin e dorës dhe fikjen e traktorit në vend sipas rregullave dhe udhëzimeve teknike;
- të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së lëvizjeve para e mbrapa me traktor;

RM 2 Nxënësi lëviz me shpejtësi të ndryshme në rrugë të drejtë me traktor me rrota.

Përmbajtja

- Hipja dhe pozicionimi në ndenjësen e traktorit.
- Ndezja e traktorit.
- Kontrolli i treguesve në kroskotin e traktorit.
- Nisja e traktorit nga vendi.
- Dhënia e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor.
- Ndërrimi i marsheve për rritjen e shpejtësisë.
- Ecja me traktor me marshin e dytë dhe të tretë.
- Ndërrimi i marsheve për uljen e shpejtësisë.
- Ndalimi, sigurimi me frenin e dorës dhe fikja e traktorit.
- Zbritja nga traktori.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë lëvizjes me traktor me shpejtësi të ndryshme në rrugë të drejtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë hipjen dhe pozicionimin në ndenjësen e traktorit sipas rregullave të përcaktuara;
- të kryejë ndezjen e traktorit sipas udhëzimeve teknike;
- të kontrollojë treguesit në kroskotin e traktorit përpara nisjes;
- të realizojë nisjen e traktorit nga vendi sipas rregullave të përcaktuara;
- të realizojë në momentin e duhur dhënien e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor;
- të zbatojë procedurën e ndërrimit të marsheve për rritjen e shpejtësisë sipas udhëzimeve teknike;

- të ecë me traktor me marshin e dytë dhe të tretë në rrugë të drejtë;
- të zbatojë procedurën e ndërrimit të marsheve për uljen e shpejtësisë sipas udhëzimeve teknike;
- të realizojë ndalimin, sigurimin me frenin e dorës dhe fikjen e traktorit në vend sipas rregullave dhe udhëzimeve teknike;
- të zbresë nga traktori sipas rregullave;
- të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë lëvizjes me traktor me shpejtësi të ndryshme në rrugë të drejtë.

RM 3 Nxënësi lëviz në kthesa me traktor me rrota.

Përmbajtja

- Hipja dhe pozicionimi në ndenjësën e traktorit me rrota.
- Ndezja e traktorit.
- Kontrolli i treguesve në kroskotin e traktorit.
- Nisja e traktorit nga vendi.
- Dhënia e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor.
- Lëvizja me traktor në kthesa të gjera nga e majta.
- Lëvizja me traktor në kthesa të gjera nga e djathta.
- Lëvizja me traktor në kthesa të ngushta nga e majta.
- Lëvizja me traktor në kthesa të ngushta nga e djathta.
- Ndalimi, siguri me frenin e dorës dhe fikja e traktorit.
- Zbritja nga traktori.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë lëvizjes në kthesa me traktor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë hipjen dhe pozicionimin në ndenjësën e traktorit sipas rregullave të përcaktuara;
- të kryejë ndezjen e traktorit sipas udhëzimeve teknike;
- të kontrollojë treguesit në kroskotin e traktorit përpara nisjes;
- të realizojë nisjen e traktorit nga vendi sipas rregullave të përcaktuara;
- të realizojë në momentin e duhur dhënien e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor;
- të zbatojë procedurën e lëvizjes me traktor në kthesa të gjera nga e majta sipas udhëzimeve teknike;
- të zbatojë procedurën e lëvizjes me traktor në kthesa të gjera nga e djathta sipas udhëzimeve teknike;
- të zbatojë procedurën e lëvizjes me traktor në kthesa të ngushta nga e majta;
- të zbatojë procedurën e lëvizjes me traktor në kthesa të ngushta nga e djathta;

- të realizojë ndalimin, sigurimin me frenin e dorës dhe fikjen e traktorit në vend sipas rregullave dhe udhëzimeve teknike;
- të zbresë nga traktori sipas rregullave;
- të zbatojë me përpikëri rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë lëvizjes në kthesa me traktor.

RM 4 Nxënësi manovron traktorin me rrota, me rimorkjo durrrotëshe.

Përmbajtja

- Hipja dhe pozicionimi në ndenjësën e traktorit me rrota.
- Ndezja e traktorit.
- Kontrolli i treguesve në kroskotin e traktorit.
- Nisja e traktorit me rrota.
- Dhënia e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor.
- Lëvizja mbrapa për të afruar traktorin me rimorkjon.
- Lidhja e hallkës rimorkjuese të traktorit me ganxhën e rimorkios.
- Sigurimi i lidhjes.
- Realizimi i lidhjeve elektrike dhe të frenimit, midis rimorkjos dhe traktorit.
- Nisja nga vendi të traktorit me rimorkjo.
- Lëvizja para e traktorit me rimorkjo në rrugë të drejtë horizontale.
- Lëvizja mbrapa e traktorit me rimorkjo në rrugë të drejtë horizontale.
- Lëvizja e traktorit me rimorkjo në kthesa të gjera.
- Lëvizja e traktorit me rimorkjo në kthesa të ngushta.
- Ndalimi në vend dhe sigurimi me frena dore i traktorit me rimorkjo.
- Shkëputja e lidhjeve elektrike dhe të frenimit, midis rimorkios dhe traktorit.
- Shkëputja e hallkës rimorkjuese të traktorit me ganxhën e rimorkios.
- Largimi i traktorit nga rimorkjo.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë manovrimit të traktorit me rrota me rimorkjo.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë hipjen në traktorin me rrota sipas rregullave teknike;
- të pozicionohet në ndenjësën e traktorit sipas rregullave;
- të ndezë traktorin sipas hapave procedurale të ndezjes;
- të kontrollojë treguesit në kroskotin e traktorit, para nisjes së tij;
- të realizojë nisjen e traktorit nga vendi sipas rregullave të

- përcaktuara;
- të kryejë në momentin e duhur dhënien e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor me rrota me rimorkjo;
- të ecë mbrapa për të afruar traktorin me rimorkion sipas udhëzimeve;
- të lidhë hallkën rimorkuese të traktorit me ganxhën e rimorkios;
- të sigurojë lidhjen midis hallkës rimorkuese të traktorit me ganxhën e rimorkios;
- të realizojë lidhjet elektrike dhe të frenimit, midis rimorkios dhe traktorit.
- të zbatojë procedurën e nisjes nga vendi të traktorit me rrota me rimorkjo.
- të ecë para me traktorin me rrota me rimorkjo në rrugë të drejtë horizontale.
- të ecë mbrapa me traktorin me rrota me rimorkjo në rrugë të drejtë horizontale.
- të ecë me traktorin me rrota me rimorkjo në kthesa të gjera.
- të ecë me traktorin me rimorkjo në kthesa të ngushta.
- të realizojë ndalimin në vend dhe sigurimin me frena dore të traktorit me rrota me rimorkjo.
- të zbatojë procedurën e shkëputjes së lidhjeve elektrike dhe të frenimit, midis rimorkios dhe traktorit.
- të zbatojë procedurën e shkëputjes së hallkës rimorkuese të traktorit me ganxhën e rimorkios.
- të largojë traktorin me rrota nga rimorkioja.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së lëvizjeve me traktor me rrota me rimorkjo.

RM 5 Nxënësi vendos dhe heq makina bujqësore të varura në traktorin me rrota.

Përmbajtja

- Pozicionimi i makinës bujqësore për t'u lidhur me traktorin.
- Hipja dhe pozicionimi në ndenjësën në traktorin me rrota.
- Ndezja e traktorit.
- Kontrolli i treguesve në kroskotin e traktorit.
- Nisja e traktorit me rrota.
- Dhënia e sinjaleve gjatë vendosjes dhe heqjes së makinave bujqësore të varura në traktor.
- Lëvizja mbrapa për të afruar traktorin me makinën bujqësore.
- Lidhja së ganxhave të makinës bujqësore me hallkën lidhëse tripikëshe të mekanizmit varës-hidraulik të traktorit.
- Lidhja dhe regjistrimi i stabilizatorëve.
- Komandimi i mekanizmit varës-hidraulik për vendosjen e makinës në pozicion transportimi.

- Komandimi i mekanizmit varës-hidraulik për vendosjen e makinës në pozicione të ndryshme pune.
- Ulja e makinës bujqësore për shkëputje nga traktori.
- Shkëputja e ganxhave të makinës bujqësore me hallkën lidhëse tripikëshe të mekanizmit varës-hidraulik të traktorit.
- Largimi i traktorit nga makina bujqësore.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë vendosjes dhe heqjes së makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë hipjen në traktorin me rrota sipas rregullave teknike;
- të pozicionohet në ndenjësen e traktorit sipas rregullave;
- të ndezë traktorin sipas hapave procedurale të ndezjes;
- të kontrollojë treguesit në kroskotin e traktorit, para nisjes së tij;
- të kryejë në momentin e duhur dhënien e sinjaleve gjatë vendosjes dhe heqjes së makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota;
- të ecë mbrapa për të afruar traktorin me makinën bujqësore sipas udhëzimeve teknik;
- të lidhë ganxhën e makinës bujqësore me hallkën lidhëse tripikëshe të mekanizmit varës-hidraulik të traktorit sipas procedurës përkatëse;
- të kryejë lidhjen dhe regjistrimin e stabilizatorëve sipas rregullit përkatës;
- të realizojë komandimin e mekanizuar varës-hidraulik për vendosjen e makinës në pozicion transportimi;
- të realizojë komandimin e mekanizuar varës-hidraulik për vendosjen e makinës në pozicione të ndryshme pune;
- të realizojë uljen e makinës bujqësore për shkëputje nga traktori;
- të bëjë shkëputjen e ganxhave të makinës bujqësore me hallkën lidhëse tripikëshe të mekanizmit varës-hidraulik të traktorit sipas procedurës përkatëse;
- të ecë përpara për largimin e traktorit nga makina bujqësore;
- të zbatojë me përpikëri rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë vendosjes dhe heqjes së makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota;

Metodat e rekomanduara të mësuarit

- Ky modul duhet të trajtohet në sheshe të lira ku mund të realizohet lëvizje e lirë dhe pa rrezik me traktor me rrota.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të drejtimit para, mbrapa dhe

në kthesa të ndryshme me traktor me rrota.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të manovrimit të traktorit me rrota me rimorkio dyrrrotëshe, si dhe vendosjen dhe heqja e makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota.
- Mësuesi/instruktori duhet të nxitë diskutime përreth drejtimit të traktorit me rrota para, mbrapa dhe në kthesa, manovrimit të traktorit me rimorkio dyrrrotëshe, si dhe për vendosjen edhe heqjen e makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota.
- Instruktori duhet të përdorë manuale apo katalogje që kanë të bëjnë me drejtimin para, mbrapa e në kthesa të traktorit, si dhe me vendosjen edhe heqjen e makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të drejtuar traktorin para, mbrapa dhe në kthesa, manovruar traktorin me rimorkio dyrrrotëshe, vendosjen dhe heqjen e makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për drejtimin para, mbrapa dhe në kthesa e traktorit, manovrimit të traktorit me rimorkio dyrrrotëshe, si dhe për vendosjen edhe heqjen e makinave bujqësore të varura në traktorin me rrota.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Traktor me rrota.
 - Rimorkio.
 - Plugje
 - Frezë
 - Kultivator
 - Makina mbjellëse
 - Shesh për realizimin e sigurtë të lëvizjeve me traktor.
 - Mjedise për mirëmbajtjen ditore dhe periodike në traktor.
 - Graso (yndyrë) dhe karburante.
 - Manule teknike.
 - Katalogje të ndryshme
-

7. Moduli “Mbjellja e fidanit të pemëve frutore”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|---|--|-------------|
| Titulli dhe kodi | MBJELLJA E FIDANIT TË PEMËVE FRUTORE | M-14-140-15 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të hapur gropën, përgatitur fidanin dhe zbatuar teknikën e mbjelljes së fidanëve të pemëve frutore. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 33 orë mësimore (1 kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi hap gropën për mbjelljen e fidanit frutor.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglave dhe e pajisjeve të punës për hapjen e gropës për mbjelljen e fidanëve frutorë.– Kontrolli fizik i veglave të punës.– Transportimi i veglave të punës.– Përcaktimi i vendit për hapjen e gropave.– Piketimi i tokës me anë të dërrasës mbjellëse.– Teknika e hapjes së gropës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së gropave për mbjelljen e fidanëve frutorë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat e duhura të punës për hapjen e gropës: dërrasë mbjellëse, piketa, lopata, bela, hunj, lidhës, gëlqere, furçë dhe përzierje bajgë + deltinë;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës;– të caktojë në vend të përshtatshëm për hapjen e gropës për mbjelljen e fidanit frutor;– të piketojë në largësi të caktuar, sipas llojit ose kultivarit duke përdorur dërrasën mbjellëse;– të hapë gropën me vegla dore duke hedhur dheun në të dy krahët e gropës sipas teknikës së duhur, si dhe duke respektuar thellësinë e hapjes;– të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së gropës për mbjelljen e fidanit frutor; | |

RM 2 Nxënësi përgatit fidanin për mbjellje.

Përmbajtja

- Përcaktimi i llojit të kultivarit për mbjellje.
- Nxjerrja e fidanit nga shtratifikimi.
- Kontrolli i përgjithshëm i fidanit.
- Zhytja e fidanit në ujë.
- Shkurtimi i rrënjëve të fidanit.
- Zhytja e rrënjëve në përzierjen bajgë-deltinë dhe ujë.
- Transportimi i fidanëve në vendin e mbjelljes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes e mjedisit gjatë përgatitjes së fidanit për mbjellje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë llojin e kultivarit për mbjellje sipas kushte klimatiko-tokësore;
- të nxjerrë me shumë kujdes fidanët nga shtratifikimi;
- të kontrollojë sistemin rrënjor të fidanëve dhe t'i pastrojë ato;
- të zhytë fidanët në ujë për 1-2 ditë;
- të rifreskojë sistemin rrënjor duke shkurtuar rrënjët e dëmtuara;
- të zhytë sistemin rrënjor në përzierjen bajgë-deltinë dhe ujë sipas raporteve të përcaktuara;
- të transportojë fidanët me kujdes në vendin e mbjelljes;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së fidanëve për mbjellje;

RM 3 Nxënësi mbjell fidanin frutor.

Përmbajtja

- Shpërndarja e plehut organik e mineral pranë gropave të hapura.
- Përzierja e dheut të sipërfaqes me pleh organo-mineral.
- Mbushja e gropës me dheun e sipërfaqes së përgatitur.
- Përcaktimi i qendrës së gropës ku do të mbillet fidani.
- Mbujllja e fidanit.
- Mbushja e gropës me pjesën tjetër të dheut.
- Lidhja e fidanit me hurrin mbështetës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së mbujlljes së fidanëve të pemëve frutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpërndarjë plehun organik dhe mineral pranë gropave të hapura sipas sasisë së nevojshme.

- të përzierjë në mënyrë të njëtrajtshme dheun e sipërfaqes me plehrat organo-minerale;
- të kryejë mbushjes së gropës me dheun e sipërfaqes së përgatitur në 2/3 e thellësisë së saj;
- të përcaktojë qendrën e gropës ku do të mbillet fidani me përdorimin e dërrasës mbjellëse dhe ngulja e hurit në thellësi të gropës;
- të mbjellë fidanin sipas teknikës së mbjelljes së tyre;
- të mbushë gropën me pjesën tjetër të dheut duke lënë pikën e shartimit 7-8 cm mbi rrafshin e tokës;
- të lidhë fidanin me hurin në formë tete pak të lirë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së mbjelljes së fidanëve frutorë;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ose jashtë saj ku mund të realizohet ky modul.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të ndryshme të mbjelljes së fidanëve frutorë.
- Të diskutohen metoda për teknikën më të përshtashme të mbjelljes së fidanëve frutorë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për hapjen e gropës, përgatitjen fidanit dhe mbjelljen e tij, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kryerjen e mbjelljes së fidanëve frutorë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe toke.
 - Vegla të punës për hapjen e gropës dhe mbjelljen e fidanëve.
 - Fidanë.
 - Dërrasa mbjellëse.
 - Lidhëse
 - Hunj
 - Piketa
 - Gëlqere
 - Bajgë, deltinë
 - Gërshërë krasitëse etj
 - Manuale e katalog të ndryshem në mbështetje të modulit.
-

8. Moduli: “Mirëmbajtja e fermës bujqësore dhe blegtorale”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

| | | |
|---|--|---------------|
| Titulli dhe kodi | MIRËMBAJTJA E FERMËS BUJQËSORE DHE BLEGTORALE | (M-14-141-15) |
| Qëllimi i modulit | Një modul që aftëson nxënësit për mirëmbajtjen e fermës për punimet e instalimeve të thjeshta elektrike, axhusterie, hidraulike, ndërtimi dhe zdruthtarie në fermat bujqësore e blegtorale. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 69 orë mësimore (2 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi kryen punime të thjeshta të instalimeve elektrike në fermë. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e kompletit të veshjes së përshtatshme.– Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve përkatëse për kryerjen e instalimeve të thjeshta elektrike.– Leximi i skicës së instalimeve të thjeshta elektrike.– Kryerja e matjeve me aparate të ndryshme elektrike.– Kryerja e instalimeve të thjeshta të ndriçimit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe dhënies së ndihmës së shpejtë në rast aksidenti gjatë instalimeve elektrike. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë;– të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e instalimeve të thjeshta elektrike;– të lexojë skicën e instalimeve të thjeshta elektrike;– të kryejë matje me aparate të ndryshme elektrike;– të kryejë instalime të thjeshta të ndriçimit;– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të dhënies së ndihmës së shpejtë në rast aksidenti gjatë instalimeve elektrike; <p>RM 2 Nxënësi kryen punime të thjeshta axhusterie në fermë. Përmbajtja</p> | |

- Përgatitja e kompletin e veshjes së përshtatshme.
- Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve përkatëse për kryerjen e punimeve të thjeshta axhusterie.
- Leximi i skicës së punimeve të thjeshtë të axhusterisë.
- Kryerja e punimeve të thjeshta axhusterie në fletë metalike.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë punimeve të thjeshta të axhusterisë.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë me kompletin e veshjes së përshtatshme;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e punimeve të thjeshta axhusterie;
- të lexojë skicën për punimeve të thjeshta axhusterie
- të kryejë matje me instrumentat matës: kalibër, mikrometër, vizormatës;
- të realizojë punime të thjeshta axhusterie në fletë metalike: shënime, prerje, çpime, kthime, limime;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punimeve të thjeshta axhusterie;

RM 3 Nxënësi kryen punime të thjeshta të instalimeve hidraulike në fermë.

Përmbajtja

- Përgatitja individuale për punë me kompletin e veshjes së përshtatshme.
- Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve përkatëse për kryerjen e instalimeve të thjeshta hidraulike të ujit dhe kanalizimit.
- Leximi i skicës së instalimeve të brendshme të thjeshta hidraulike të ujit dhe kanalizimit.
- Kryerja e instalimeve të brendshme të thjeshta të furnizimit me ujë dhe kanalizimit.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë instalimeve të brendshme hidraulike.

Instrumentet e vlerësimit:

– Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë.
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e instalimeve të brendshme të thjeshta hidraulike të ujit dhe kanalizimit;
- të lexojë skicën e instalimeve të brendshme të thjeshta hidraulike;
- të kryejë instalime të brendshme të thjeshta të furnizimit

- me ujë dhe kanalizimit;
- të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë instalimeve të brendshme hidraulike;

RM 4 Nxënësi kryen punime të thjeshta zdrukthtarie në fermë.

Përmbajtja

- Përgatitja individuale për punë.
- Përzgjedhja e materialeve, veglave të dorës dhe pajisjeve.
- Leximi i skicës së punimit të thjeshtë të drurit.
- Kryerja e matjeve me pajisjet matëse.
- Kryerja e punimeve të thjeshta me vegla dore në dërrasa.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë punimeve të thjeshta të drurit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë me kompletin e veshjes së përshtatshme.
- të përzgjedhë materialet, veglat e dorës dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e punimeve të thjeshta të drurit;
- të lexojë skicën për punimeve të thjeshta të drurit;
- të kryejë matje me pajisjet matëse si: kalibër, mikrometër, vizormatës;
- të realizojë punime të thjeshta me vegla dore, të dërrasave si: shënim, sharrim, zdrukthim.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik gjatë punimeve të thjeshta të drurit;

RM 5 Nxënësi kryen punime të thjeshta ndërtimi në fermë.

Përmbajtja

- Përgatitja individuale për punë .
- Përzgjedhja e materialeve, veglave të dorës dhe pajisjeve.
- Leximi i skicës së thjeshtuar të një mjedisi.
- Përgatitja e llaçit dhe betonit.
- Kryerja e punimeve të thjeshta të një muri me tulla 25 cm.
- Kryerja e punimeve të thjeshta të një arkitrari prej betoni të armuar.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë punimeve të thjeshta të ndërtimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë me kompletin e veshjes së përshtatshme;
- të përzgjedhë materialet, veglat e dorës dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e punimeve të thjeshta të ndërtimit;
- të lexojë skicat e thjeshtuara të një mjedisi: plan, prerje;

- të përgatisë llaçe dhe betone me raporte të dhëna të përbërësve;
- të realizojë punime të thjeshta të një muri 25 cm si: muraturë, suvatim, veshje me pllakë, bojatisje;
- të realizojë punime të thjeshta të një arkitrari prej betoni të armuar: kallëpi, hekuri, betonimi;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të thjeshta të ndërtimit;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për punimet mirëmbajtëse të fermës, instalime të thjeshta elektrike dhe hidraulike, punime të thjeshta axhusterie, të drurit dhe të ndërtimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për punimet mirëmbajtëse të fermës (instalime të thjeshta elektrike dhe hidraulike, punime të thjeshta axhusterie, të drurit dhe të ndërtimit), fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me punimet mirëmbajtëse të fermës: instalime të thjeshta elektrike dhe hidraulike, punime të thjeshta axhusterie, të drurit dhe të ndërtimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për punimet mirëmbajtëse të fermës: instalime të thjeshta elektrike dhe hidraulike, punime të thjeshta axhusterie, të drurit dhe të ndërtimit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisi ku do të bëhen instalime elektrike dhe hidraulike, si dhe punime të thjeshta axhusterie, druri dhe ndërtimi.
 - Kompleti i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punimet mirëmbajtëse të fermës (instalime të thjeshta elektrike dhe hidraulike, punime të thjeshta axhusterie, të drurit dhe të ndërtimit).
 - Manuale dhe katalogë në mbështetje të modulit.
-

9. Moduli “Punimi i mekanizuar i tokës”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|--|-------------|
| Titulli dhe kodi | PUNIMI I MEKANIZUAR I TOKËS | M-14-142-11 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që aftëson nxënësit për kryerjen e punimeve të mekanizuara të tokës bujqësore. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 51 orë mësimore (1,5 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi kryen plugimin e mekanizuar të tokës.</p> <p><i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e uniformës së veshjes për punë.– Analiza e punimit që do të kryhet.– Përzgjedhja e plugut të varur.– Kontrolli i gjendjes së traktorit me rrota dhe plugut.– Pastrimi i parcelës nga objektet e forta.– Lidhja e plugut të varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit.– Vendosja e plugut në pozicion transporti.– Ecja me traktor për në parcelë.– Pozicionimi i traktorit për plugim.– Pozicionimi dhe regjistrimi i plugut të varur për plugim.– Kryerja e plugimit të drejtë.– Realizimi i kthimit të traktorit me plug.– Kontrolli dhe rregullimi i plugimit.– Vendosja e plugut në pozicion transporti.– Largimi nga parcela i traktorit me plugun e varur.– Shkëputja e plugut të varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së plugimit të mekanizuar të tokës. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatitë dhe të veshë uniformën e punë;– të bëjë analizën e punimeve që do të kryhet;– të përzgjedhë plugun e varur sipas llojit të tokës dhe thellësisë së punimit; | |

-
- të kontrollojë gjendjen e traktorit me rrota dhe të plugut.
 - të bëjë pastrimin e parcelës të caktuar për plugim nga objektet e forta;
 - të bëjë lidhjen e plugut të varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit;
 - të vendosë plugun në pozicion transporti;
 - të ecë me traktor për në parcelën që do të plugohet;
 - të pozicionojë traktorin për plugim;
 - të pozicionojë dhe regjistrojë plugun e varur për plugimin e kërkuar;
 - të kryejë plugimin e tokës duke ruajtur drejtimin e duhur;
 - të realizojë kthimin e traktorit me plug;
 - të kontrollojë dhe rregullojë plugimin e tokës;
 - të vendosë plugun në pozicion transporti;
 - të largojë nga parcela traktorin me plugun e varur;
 - të shkëputë plugun e varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së plugimit të mekanizuar të tokës.

RM 2 Nxënësi kryen diskimin e mekanizuar të tokës.

Përmbajtja

- Përgatitja e uniformës së veshjes për punë.
- Analiza e punimit që do të kryhet.
- Përzgjedhja e diskut për diskimin e tokës.
- Kontrolli i gjendjes së traktorit me rrota dhe e diskut.
- Lidhja e diskut të varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit.
- Vendosja e diskut në parcelën që do të diskohet.
- Pozicionimi i traktorit për diskim.
- Pozicionimi dhe regjistrimi i diskut të varur për diskimin e kërkuar.
- Kryerja e diskimit të tokës së pluguar.
- Realizimi i kthimit të traktorit me disk.
- Kontrolli dhe rregullimi i diskimit.
- Vendosja e diskut në pozicion transporti.
- Largimi nga parcela i traktorit me diskun e varur.
- Shkëputja e diskut të varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së diskimit të mekanizuar të tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë dhe të veshë uniformën e punës;
- të bëjë analizën e punimit që do të kryhet;
- të përzgjedhë diskun sipas llojit të tokës;

- të kontrollojë gjendjen e traktorit me rrota dhe të diskut.
- të lidhë diskun e varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit;
- të vendosë diskun në parcelën që do të diskohet;
- të pozicionojë traktorin për diskim;
- të pozicionojë dhe të regjistrojë diskun e varur për diskimin e kërkuar;
- të kryejë diskimin e tokës së pluguar;
- të realizojë kthimin e traktorit me disk;
- të kontrollojë dhe të rregullojë diskimin;
- të vendosë diskun në pozicion transporti;
- të largojë nga parcela traktorin me diskun e varur;
- të shkëputë diskun e varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së diskimit të mekanizuar të tokës.

RM 3 Nxënësi kryen frezimin e mekanizuar të tokës.

Përmbajtja

- Përgatitja e uniformës së veshjes për punë.
- Analiza e punimit që do të kryhet.
- Përzgjedhja e llojit të frezës për frezimin e kërkuar.
- Kontrolli i gjendjes së traktorit me rrota dhe frezës.
- Lidhja e frezës së varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit.
- Vendosja e frezës në pozicion transporti.
- Ecja me traktor për në parcelën që do të frezohet.
- Pozicionimi i traktorit për frezim.
- Pozicionimi dhe regjistrimi i frezës së varur për punë.
- Kryerja e frezimit të tokës.
- Realizimi i kthimit të traktorit me frezë.
- Kontrolli dhe rregullimi i frezimit.
- Vendosja e frezës në pozicion transporti.
- Largimi nga parcela i traktorit me frezën e varur.
- Shkëputja e frezës të varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë frezimit të tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë dhe të veshë uniformën e punës;
- të bëjë analizën e punimit që do të kryhet;
- të përzgjedhë frezën sipas llojit të tokës;
- të kontrollojë gjendjen e traktorit me rrota dhe të frezës.
- të lidhë frezën e varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit;

- të vendosë frezën në parcelën që do të frezohet;
- të pozicionojë traktorin për frezim;
- të pozicionojë dhe të regjistrojë frezën e varur për frezimin e kërkuar;
- të kryejë frezimin e tokës;
- të realizojë kthimin e traktorit me frezë;
- të kontrollojë dhe të rregullojë frezimin;
- të vendosë frezën në pozicion transporti;
- të largojë nga parcela traktorin me frezën e varur;
- të shkëputë frezën e varur me mekanizmin varës-hidraulik të traktorit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së frezimit të mekanizuar të tokës

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në parcelën pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përgatitjen e plugut, disqeve e frezave për punë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e plugut, disqeve, frezave për plugimin, diskimin dhe frezimin e tokës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me përgatitjen e plugut, disqeve, frezave për plugimin, diskimin dhe frezimin e tokës bujqësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përgatitjen e plugut, disqeve, frezave për punë dhe realizimin e plugimit, diskimit, frezimit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen parcela, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Parcela për realizimin e punimeve të mekanizuara.
 - Traktor me rrota ose zetar.
 - Bateri disqesh (Vdhe X).
 - Lloje frezash (shatëza), disqesh dhe plugjesh.
 - Matës thellësie.
 - Komplet i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për përgatitjen e plugut, disqeve dhe frezave për punë.
-

10. Moduli: “Ujitja e bimëve të arave dhe e perimeve”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kodi | UJITJA E BIMËVE TË ARAVE DHE E PERIMEVE | M-14-1136-15 |
|---|--|--------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika në bimët e arave dhe perimeve në fermë. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 51 orë mësimore (1,5 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësit përgatiten për realizimin e ujitjeve me mënyra të ndryshme.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për kryerjen e ujitjeve.– Përcaktimi i tokës së mbjellë për ujitje.– Transportimi i veglave dhe i pajisjeve të nevojshme.– Interpretimi dhe skicimi i skemave të ujitjes së tokës.– Përcaktimi i kohës dhe i mënyrës së ujitjes.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes për ujitjen me mënyra të ndryshme. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhin veglat, pajisjet për kryerjen e ujitjeve sipas kulturës dhe mënyrës së ujitjes.– të përcaktojnë tokën e mbjellë për ujitje sipas kulturave.– të transportojnë veglat dhe pajisjet në vendin e caktuar.– të interpretojnë dhe skicojnë sipas skicave të gatshme skema për ujitjen e tokës.– të përcaktojnë kohën dhe mënyrën e duhur të ujitjes sipas llojit të kulturës, tipit dhe pjerrësisë së tokës bujqësore.– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme. | |

RM 2 Nxënësit kryejnë ujitje sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i kulturës për ujitjen sipërfaqësore me brazda.
- Përcaktimi i gjerësisë dhe i largësisë së brazdave.
- Hapja e brazdave.
- Lëshimi i ujit në brazdë.
- Përcaktimi i kohës së qëndrimit të ujit në brazdë.
- Ndjekja e lëvizjes së ujit në brazdë.
- Kryerja e ujitjes sipërfaqësore me rrëshqitje.
- Kontrolli i cilësisë së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Pastrimi dhe ruajtja e veglave dhe pajisjeve të ujitjes sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë kulturën që i përshtatet ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- të përcaktojnë gjerësinë dhe largësinë e brazdave sipas llojit të tokës.
- të hapin brazdat duke zbatuar parametrat teknikë sipas përbërjes mekanike, pjerrësisë së tokës etj.
- të lëshojnë ujin në brazdë me një rrymë fillestare të caktuar për të mbërritur sa më shpejt në fund të saj.
- të përcaktojnë kohën e qëndrimit të ujit në brazdë sipas përbërjes grimcametrike të tokës.
- të ndjekin lëvizjen e ujit në brazdë sipas drejtimit të mbjelljes së bimëve.
- të kryejnë ujitjen sipërfaqësore me rrëshqitje sipas pjerrësisë së tokës.
- të kontrollojnë cilësinë e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje për plotësimin e kërkesave teknike.
- të pastrojnë dhe ruajnë veglat dhe pajisjet për ujitjen sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- të zbatojnë rregullave e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

RM3 Nxënësit kryejnë ujitjen me shihedhje.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e kulturës.
- Kontrolli i impiantit shihedhës.
- Montimi i impiantit ujitës.
- Lëshimi i ujit.

- Kontrolli i vazhdueshëm gjatë kryerjes së ujitjes.
- Çmontimi i impiantit ujitës.
- Pastrimi dhe ruajtja e impiantit ujitës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli i punës së bërë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përzgjedhin kulturën që i përshtatet ujitjes me shihedhje.
- të kontrollojnë impiantin shihedhës për funksionim të rregullt të tij.
- të montojnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të lëshojnë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e ujitjes për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- të çmontojnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.

RM 4 Nxënësit kryejnë ujitjen me pika.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e kulturës.
- Përzgjedhja e tubave, pikatoreve dhe transportimi i tyre.
- Montimi i tubave dhe pikatoreve në tubacione.
- Përcaktimi i normës së ujitjes.
- Lëshimi i ujit.
- Kontrolli i vazhdueshëm i ujitjes me pika.
- Çmontimi i pikatoreve.
- Pastrimi dhe ruajtja e pikatoreve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me pika.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli i punës së bërë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përzgjedhin kulturën që i përshtatet ujitjes me pika.
- të përzgjedhin pikatorët e duhura në varësi të kulturës dhe t'i transportojnë ato.
- të montojnë tubat dhe pikatorët në tubacione sipas kushteve teknike.
- të përcaktojnë normën e ujitjes sipas formulës së dhënë.

- të lëshojnë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme ujitjen me pika për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- të çmontojnë tubat e çmontueshëm dhe pikatoret sipas kushteve teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë pikatoret sipas kërkesave teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ujitjes me pika.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në ferma bujqësore të cilat praktikojnë mënyra të ndryshme të ujitjes.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe impianteve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe impianteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi
- i shkallës së arritjes së shprehive praktike për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme:
- Skica të gatshme me skema për rrjetin e ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.
 - Impiant për ujitjen me shihedhje dhe me pika,
 - Tubacione, etj.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli: “Kultivimi i luleve në mjedise të hapura”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 10

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|---|--|--------------------|
| Titulli dhe kodi | KULTIVIMI I LULEVE NË MJEDISE TË HAPURA | M-14-146-09 |
| Qëllimi i modulit | Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për kultivimin e luleve dekorative në mjedise të hapura. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 36 orë mësimore (kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi prodhon fidanë lulësh për mbjellje në fushë të hapur. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja dhe përgatitja veglave dhe materialeve për prodhimin e fidanëve të luleve.– Përcaktimi i llojit të luleve për mbjellje.– Përcatimi i sasisë së farës për mbjellje.– Teknika e përgatitjes së dherishtes për mbjelljen e farës së luleve.– Teknika e përgatitjes së shtratit të mbjelljes së farës së luleve.– Teknika e mbjelljes së farës së luleve.– Mbulimi i farës së luleve.– Plehërimi dhe punimet plotësuese pas mbjelljes së farës së luleve.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat dhe materialet për prodhimin e fidanëve të luleve;– të përcaktojë llojet e luleve sipas kushteve klimatiko-tokësore;– të përcaktojë saktë sasinë e farës për mbjellje sipas | |

-
- madhësisë së sipërfaqes dhe dendësisë së bimëve;
 - të zbatojë teknikën e përgatitjes së dherishten sipas raporteve të sakta të plehut dhe dheut;
 - të përgatisë shtartin e mjelljes sipas teknikës më të përshtatshme;
 - të zbatojë me korrektësi teknikën e mbjelljes së farës së luleve;
 - të zbatojë me korrektësi teknikën e mbulimit të farës;
 - të kryejë shërbimet në farishte pas mjelljes sipas kërkesës;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve.

RM 2 Nxënësi kultivon me fidanë lule në mjedis të hapura.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e veglave dhe materialeve për mbjelljen e fidanëve.
- Përcaktimi i vendit për mbjelljen e fidanëve të luleve.
- Teknika e piketimit të sipërfaqes për mbjelljen e fidanëve.
- Shkulja e fidanëve.
- Zgjedhja e fidanëve të shëndetshëm për mbjellje.
- Teknika e mbjelljes së fidanëve.
- Ujitja e lehtë e fidanëve të porsa mbjellë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të luleve me fidanë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë saktë veglat dhe materialet për mbjelljen e fidanëve.
- të përcaktojë vendin për mbjelljen e fidanëve të luleve sipas kriterëve të përcaktuara;
- të piketojë sipërfaqes për mbjelljen e fidanëve sipas kërkesës;
- të shkulë me kujdes fidanët;
- të përcaktojë fidanët e shëndetshëm për mbjellje;
- të mbjellë fidanët sipas distancave të përcaktuara;
- të kryejë ujitjen së lehtë e fidanëve të porsa mbjellë sipas nevojave;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të luleve me fidanë.

RM 3 Nxënësi kujdeset për rritjen e bimëve pas mbjelljes.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave dhe materialeve për kryerjen e shërbimeve pas mbjelljes së fidanëve.
- Teknika e kontrollit të zënies së fidanëve.
- Teknika e zëvendësimit të boshllëqeve.
- Teknika e ujitjes së luleve.

- Teknika e prashitjes së luleve.
- Teknika e heqjes së barërave të këqija.
- Teknika e kryerjes së plehrimit plotësues.
- Teknika e krasitjes së gjelbër e bimëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve për rritjen e luleve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë saktë veglat e dorës për kryerjen e shërbimeve pas mbjelljes së fidanëve;
- të kryejë kontrollim e zënies së fidanëve të mbjellë sipas teknikës përkatëse;
- të ujisë bimët lulore sipas nevojave specifike të tyre;
- të zëvendësojë bimët e thara me fidanë të rinj të shëndetshëm;
- të prashitë lulet me thellësinë e duhur sipas llojit të luleve;
- të bëjë plehrimin plotësues të luleve sipas kërkesave dhe dozave përkatëse;
- të shkullë dhe largojë barërat e këqia;
- të krasisë bimët gjatë vegjetacionit;
- të zbatimi drejt rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve për rritjen e luleve.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese, oborrin e shkollës e sipërmarrjet private të prodhimit të luleve e fermat pranë shkollës.
- Mësuesi instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimore në sera ku prodhohen fidanë lulor dhe kopshte botanike dhe vende të tjera publike të zbukuruara me lule të ndryshme.
- Nxënësit duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e kultivimit të luleve njëvjeçare, dyvjeçare dhe shumëvjeçare. Kjo duhet të përfshijë përgatitjen e tokës, mbjelljen e farës, mbjelljen e fidanëve dhe kujdesin për rritjen e tyre.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet praktike për përgatitjen e tokës për mbjellje, mbjelljen e farës, mbjelljen e fidanit dhe shërbimet pas mbjelljes. Ai duhet të nxisë fantazinë e nxënësve për ide racionale për prodhimin e luleve.
- Realizimi i pranuehëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe toke të caktuara në shkollë, fermë, qytet etj
 - Katalogë për lulet, fotografi, diapozitiva
-

-
- Farëra të ndryshme lulore
 - Plehra organike e minerale
 - Metër-shirit
 - Piketa
 - Spango
 - Tel, lopata, bela,
 - Gërshërë krasitjeje, brisqe, sharrë etj
-

2. Moduli “Kujdesi gjatë rritjes së bletëve”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 10

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|--|-------------|
| Titulli dhe kodi | KUJDESI GJATË RRRITJES SË BLETËVE | M-14-147-09 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për mirëmbajtjen, funksionimin e pajisjeve dhe mjeteve për kujdesin gjatë rritjes së bletëve dhe për marrjen e mjaltit. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 36 orë mësimore (1 kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi kryen shërbime të thjeshta gjatë rritjes së bletëve. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Kryerja e punëve thjeshta në shërbimet kryesore gjatë ngrohjes dhe çeljes së vezëve.– Kryerja e punëve thjeshta në përgatitjen e ushqimit për larvat.– Kryerja e punëve thjeshta në pastrimin e zgjoit.– Kryerja e punëve thjeshta në kontrollin për sëmundjet dhe dëmtuesit e bletëve.– Kryerja e punëve thjeshta në plotësimin e nevojave të bletëve për ushqim.– Kryerja e punëve thjeshta në plotësimin e nevojave të bletëve për ujë.– Kryerja e punëve të thjeshta në vendosjes e piteve në korniza në zgjua.– Kryerja e punëve të thjeshta në kujdesjen gjatë shtimit të bletës (roihta).– Kryerja e punëve të thjeshta në grumbullimin e mizës (kapja e roit të ri).– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë rritjes së punëve të thjeshta në shërbimet për rritjen e bletëve Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të kryejë punë të thjeshta për shërbimet kryesore gjatë ngrohjes dhe çeljes së vezëve dhe rritjes së larvave;– të kryejë punë të thjeshta për përgatitjen e ushqimit të | |

-
- larvave;
- të kryejë punë të thjeshta për pastrimin e zgjoit;
 - të përzgjedhë vendin e ngritjes së parkut të bletëve në përshtatje me kushtet klimatike dhe burimet e ushqimit;
 - të kryejë punë të thjeshta për kontrollin e zgjoit për sëmundje dhe dëmtues;
 - të kryejë punë të thjeshta për përgatitjen e ushqimit artificial të bletëve sipas udhëzimeve të specialistit të rritjes së bletëve;
 - të përgatisë ujin për bletët gjatë stinës së verës, në vazo e fuçi me rubinet, pjata, tava, etj.,
 - të kryejë operacione ndihmëse për vendosjen e piteve në korniza në zgjua.
 - të përgatisë saktë shportat dhe arkat – kurthe për grumbullimin e mizes (roit).
 - të vendosë në zgjoin e parapërgatitur (roin e ri) në vendin e duhur.
 - të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve ndihmëse në shërbimet për rritjen e bletëve;

RM 2 Nxënësi përgatit veglat dhe orenditë për marrjen e mjaltit ***Përmbajtja***

- Përzgjedhja e veglave dhe orendive të punës për ndërhyrjet në zgjua.
- Përgatitja e veshjes speciale për ndërhyrjet në zgjua.
- Përgatitja e veglave dhe e orendive për ndërhyrje në zgjua.
- Përcaktimi i përdorimit të i veglave e orendive sipas radhës:
- Transportimi i veglave në vendin e duhur pranë zgjoit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së veglave e orendive për ndërhyrje në zgjua;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë veglat dhe orenditë për ndërhyrjet në zgjua;
- të përgatitë siç duhet veshjen speciale për ndërhyrje në zgjua;
- të përgatisë siç duhet veglat dhe orenditë e punës për ndërhyrje në zgjua;
- të përcaktojë saktë radhën e përdorimit të veglave dhe pajisjeve sipas llojit të ndërhyrjes në zgjua: si maskën e fytyrës, dorezat e llastikut, tymësen, levat për hapjen e zgjoit, thikat dhe pirunjtë metalik, etj;
- të transportojë në kohën dhe vendin e duhur veglat dhe orenditë e ndërhyrjes në zgjua;

- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve ndihmëse në shërbimet për rritjen e bletëve;

RM 3 Nxënësi kryen punë të thjeshta gjatë marrjes së mjaltit.

Përmbajtja

- Përcaktimi i veglave dhe pajisjeve për marrjen e mjaltit në zgjua.
- Përcaktimi i operacioneve për marrjen e mjaltit.
- Teknika e hapjes së zgjoit të bletës.
- Teknika e nxjerrjes së piteve nga korniza.
- Teknika e shkrirjes së dyllit.
- Teknika e grumbullimit të dyllit.
- Teknika e centrifugimit.
- Transportimi i prodhimit për depozitim.
- Ruajta e prodhimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë marrjes së mjaltit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë saktë veglat dhe pajisjet për marrjen e mjaltit në zgjua;
- të përcaktojë radhën e kryerjes së operacioneve për marrjen e mjaltit;
- të kryejë punë të thjeshta për hapjen e zgjoit të bletës;
- të kryejë punë të thjeshta për nxjerrjen e piteve nga korniza;
- të kryejë punë të thjeshta për shkrirjen së dyllit;
- të kryejë punë të thjeshta në grumbullimin e dyllit;
- të kryejë punë të thjeshta gjatë centrifugimit;
- të transportojë me sukses i prodhimit për depozitim;
- të kryejë punë të thjeshta për ruajtjen e prodhimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë marrjes së mjaltit.;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikën profesionale pranë shkollës ose në park bletësh.
- Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në park bletësh duke iu dhënë mundësi nxënësve për të vrojtur konkretisht disa nga shërbimet që bëhen për mirërritjen e tyre.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të përdorimit sa më të mirë të veglave të punës, orendive dhe pajisjeve në një park bletësh si dhe të kryerjes së shërbimeve për rritjen e bletëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të kryerjes së shërbimeve për rritjen e bletëve vetëm në mbikqyrje të instruktorit apo specialistit të rritjes së bletëve.

-
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për kryerjen e shëbimëve për rritjen e bletëve.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të kryerjes së shëbimëve për rritjen e bletëve.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Park për rritjen e bletëve.
 - Vegla pune, orendi dhe pajisje për të punuar me bletën.
 - Centrifugë mjalti, kova, fuçi, bidona.
 - Veshje speciale, maska për fytyrën, doreza llastiku, tymëse, etj.
 - Pite, korniza me hoje.
 - Ushqime artificiale (shurup).
 - Vazo e fuçi me rubinet, pjata, tava,
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-

3. Moduli “Përgatitja e kompostove”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kod | PËRGATITJA E KOMPOSTOVE | (M-14-151-15) |
|--|---|---------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer ruajtjen e ftohtë e të ngrohtë të plehut organik të stallës, si dhe për përgatitjen e kompostove me mbeturina të ndryshme. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 36 orë mësimore (1 kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për praninë | Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi përgatitet për ruajtjen e plehut organik të stallës. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e uniformës së veshjes të përshtatshme për punë.– Përcaktimi i radhës së kryerjes së punëve për ruajtjen e plehut organik të stallës.– Përcaktimi i vendit për ruajtjen e plehut.– Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe mjeteve të punës për ruajtjen e plehut.– Transportimi i mjeteve të punës në vendin e caktuar.– Grumbullimi i plehut në vendin e caktuar.– Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë transportit të veglave, mjeteve e materialeve në vendin e caktuar për ruajtjen e plehut. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshë patjetër uniformën e punës;– të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë;– të caktojë vendin e ruajtjes së plehut pranë një stalle ose mbeturinave bimore;– të përzgjedhë materialet dhe veglat e duhura të punës; cfurqe, bela, lopata, plehëra organikë, kashtë, plehëra qyteti;– të transportojë me kujdes veglat dhe mjetet e punës në vendin e caktuar;– të grumbullojë plehun, kashtën, mbetjet e zonës etj, në vendin e caktuar | |

-
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes për ruajtjen e plehut;

RM 2 Nxënësi kryen ruajtjen e ftohtë (anaerobike) të plehut të stallës

Përmbajtja

- Vendosja e plehut të stallës në kavaletë.
- Ngjeshja e kavaletit me këmbë.
- Mbulimi i kavaletit me shtresë dheu.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe shëndetsor dhe ruajtja e mjedisit gjatë ruajtjes së ftohtë të plehut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vendosë plehun e stallës në kavaletë pjesë-pjesë;
- të ngjeshë kavaletin me këmbë ose me mjete të tjera;
- të mbulojë kavaletin me një shtresë dheu 5–8 cm ;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ruajtjes së ftohtë të plehut;

RM 3 Nxënësi kryen ruajtjen e ngrohtë (aerobike) të plehut të stallës

Përmbajtja

- Vendosja e plehut të stallës në kavaletë pa u ngjeshur.
- Mbulimi i kavaletit.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe shëndetsor dhe ruajtja e mjedisit gjatë ruajtjes së nxehtë të plehut

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vendosë plehun e stallës në kavaletë pjesë-pjesë pa u ngjeshur në kushte të mira ajrimi
- të mbulojë kavaletin
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik, shëndetësor dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ruajtjes së nxehtë të plehut

RM 4 Nxënësi përgatit komposto me mbeturina bimore

Përmbajtja

- Grirja e kashtës.
- Lagia e kashtës.
- Vendosja në shtresa e masës së lagur.
- Përzierja e masës me plehëra minerale ose organike.
- Vendosja e shtresave të tjera të kashtës së grirë.
- Mbulimi me shtresë dheu.
- Rregullat e sigurimit teknik, shëndetësor dhe ruajtja e mjedisit gjatë përgatitjes së kompostos me mbeturina

bimore

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të grijë kashtën sipas kërkesave
- të lagë kashtën me një sasi të caktuar uji
- të vendosë në shtresë masën me trashësi 10 – 15 cm
- të përziejë masën me plehëra minerale (azotike, fosforike, potasike) ose organike
- të vendosë shtresa të tjera pjesë-pjesë deri sat ë bëhet kavaleti
- të mbulojë kavaletin me shtresë dheu 5 – 8 cm
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së kompostos me mbeturina bimore

RM 5 Nxënësi përgatit komposto me plehërat e zonës.

Përmbajtja

- Grumbullimi i plehërave dhe fekaleve të banesave përreth.
- Pastrimi nga materialet jo-organike.
- Përcaktimi i raportit pleh – fekale.
- Përzierja e plehërave me fekale.
- Vendosja e masës në shtresa (kavalet).
- Ngjeshja e kavaletit.
- Mbulimi me shtresë dheu.
- Rregullat e sigurimit teknik e shëndetësor dhe ruajtja e mjedisit gjatë përgatitjes së kompostos me plehërat e qytetit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të grumbullojë plehërat dhe fekalet e banesave përreth
- të pastrojë plehun dhe mbeturinat nga materialet joorganike (qelq, gurë, lëndë plastike, metale)
- të përcaktojë raportin pleh – fekale: 60-70% pleh me 40-30% fekale
- të përziejë mirë plehun me fekale
- të vendosë masën në shtresa (kavalet) pjesë-pjesë
- të ngjeshë kavaletin
- të mbulojë me shtresë dheu 5 – 8 cm
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së kompostos me plehërat e qytetit

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë stallave dhe mbeturinave të ndryshme bimore të rajonit.

e nxënësve.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove me mbeturina të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove me mbeturina të ndryshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës pranë stallave dhe mbeturinave të ndryshme bimore e të qytetit.
 - Komploti i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë dhe përgatitjen e kompostove.
 - Plehra organike.
 - Mbeturina të zonës.
-

4. Moduli “Mirëmbajtja e makinave bujqësore”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kodi | MIRËMBAJTJA E MAKINAVE BUJQËSORE | M-14-143-11 |
|---|--|-------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul që aftëson nxënësit për mirëmbajtjen e pajisjeve mekanike që përdoren për kryerjen e punimeve bujqësore. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 34 orë mësimore (1 kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi kryen përgatitjet për mirëmbajtjen e makinerive bujqësore. <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja individuale për punë me kompletin e veshjes së përshtatshme– Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve përkatëse për kryerjen e mirëmbajtjes së makinerive– Kontrolli i gjendjes fizike të makinerive para dhe pas kryerjes së punimeve bujqësore– Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë mirëmbajtjes së makinerive <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë– të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e mirëmbajtjes së makinerive– të kryejë me saktësi kontrollin e makinerive dhe të përcaktojë llojin e mirëmbajtjes për çdo makineri– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së makinerive <p>RM 2 Nxënësi kryen pastrimin e makinerive. <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Pastrimi i makinerive nga pluhuri– Pastrimi i makinerive nga balta.– Pastrimi i makinerive nga vajrat.– Pastrimi i makinerive nga mbetje të tjera– Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë pastrimit të makinerive. | |

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pastrojë me cilësi makineritë nga pluhuri;
- të pastrojë me cilësi makineritë nga balta;
- të pastrojë me cilësi makineritë nga vajrat,
- të pastrojë me cilësi makineritë nga mbetjet e tjera;
- të pastrojë me cilësi makineritë nga graso;
- të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të makinerive

RM 3 Nxënësi kryen lubrifikimin e makinerive.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e grason.
- Gratatimi i pjesëve të makinerive.
- Matja e sasisë së vajit dhe ujit.
- Ndërrimi i vajit dhe ujit.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë gratatimit të makinerive.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë grason e duhur;
- të grasatojë me cilësi pjesët e makinerive;
- të masë sasinë e vajit në karter dhe sasinë e ujit në depozitën e radiatorit;
- të hedhë vajin dhe ujin;
- të zbatojë me rigozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gratatimit, matjes së nivelit të vajit dhe ujit, si dhe të hedhjes së vajit dhe të ujit.

RM 4 Nxënësi kryen mirëmbajtjen në ruajtje të makinerive bujqësore.

Përmbajtja

- Lyerja me vaj të djegur e pjesëve të ekspozuara ndaj oksidimit.
- Lyerja me bojë e pjesëve të ndryshme të makinerive.
- Mbulimi i makinerive bujqësore.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë lyerjes me vajra të djegur e bojëra

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të lyejë me kujdes me vaj të djegur të gjitha pjesët e ekspozuara ndaj oksidimit
- të lyejë me bojëra të përshtatshme pjesë të ndryshme të

makinerive

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së makinerive në ruajtje;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e parkut të makinerive bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për punimet e mirëmbajtëse së makinerive në ruajtje.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për punimet për mirëmbajtjen e makinerive në ruajtje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me punimet për mirëmbajtjen e makinerive në ruajtje.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për mirëmbajtjen e makinerive në ruajtje.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisi i parkut të makinerive bujqësore ku do të bëhen punimet mirëmbajtëse.
 - Komplet i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punimet e mirëmbajtjes së makinerive bujqësore
-

5. Moduli “Shtimi me copa i drufrutorëve”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe Kodi | SHTIMI ME COPA I DRUFRUTORËVE | M-14-149-15 |
|---|--|-------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul që aftëson nxënësit për të shtuar pemët drufrutorë me copa të thjeshta, kamza dhe përpaja. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 34 orë mësimore (1 kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi shton pemët frutore me anë të copave të thjeshta.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve për mbjelljes e copave.– Transportimi i veglave, pajisjeve e materialeve në vendin e punës.– Teknika e marrjes së copave të thjeshta nga pemët frutore mëmë.– Përcaktimi i ngastrës së copëtores për mbjelljen e copave.– Përgatitja e copëtores për mbjelljen e copave.– Kryerja e piketimit të copëtores.– Kryerja e mbjelljes së copëzave.– Ngjeshja dhe mbulimi me dhë të shkrifët.– Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë mbjelljes së copave të pemëve frutore. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet e nevojshme për mbjelljen e copave të thjeshta të pemëve frutore;– të marrë copat e thjeshta nga bimët mëmë sipas kriterëve dhe llojit të pemës frutore;– të përcaktojë ngastrën për copëtores sipas parametrave të kërkuara;– të përgatisë përgatisë për mbjellje parcelën sipas radhës së punës: punimin, pastrim dhe plehërim etj duke iu përmbajtur kriterëve;– të piketojë copëtores duke ruajtur largësinë konstante midis rrjeshtave dhe midis copëzave në rrjesht; | |

- të mbjellë në çdo gropë në thellësinë e caktuar copëzat;
- të ngjeshë mirë dhe të mbulojë me dhë të shkrifët çdo copat të mbjellë.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së copëzave të pemëve frutore .

RM 2 Nxënësi shton pemët frutore me anë të kamzave.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve përkatëse për mbjelljes e kamzave të pemëve frutore.
- Transportimi i veglave, pajisjeve e materialeve në vendin e punës.
- Përcaktimi i ngastrës dhe përgatitja e saj për mbjelljen kamzat e pemëve.
- Kryerja e piketimit të ngastrës.
- Marrja e kamzave nga bimët e rritura.
- Kryerja e mbjelljes së kamzave.
- Ngjeshja dhe mbulimi me dhë të shkrifët.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë mbjelljes së kamzave të pemëve frutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet e nevojshme për mbjelljen e kamzave të thjeshta të pemëve frutore.
- të marrë kamzat nga bimët mëmë sipas kriterëve dhe llojit të pemës frutore;
- të përcaktojë ngastrën për mbjelljen e kamzave sipas parametrave të kërkuara;
- të përgatisë ngastrën për mbjellje sipas radhës së punës: punim, pastrim dhe plehërim etj duke iu përmbajtur kriterëve;
- të piketojë ngastrën duke ruajtur largësinë konstante midis rrjeshtave dhe midis kamzave në rresht;
- të marrë kamzat nga pemët mëmë sipas kriterëve dhe llojit të pemës frutore duke zbatuar me rigorozitet teknikën e marrjes;
- të mbjellë në çdo gropë në thellësinë e caktuar kamzat;
- të ngjeshë mirë dhe të mbulojë me dhe të shkrifët çdo kamëz;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së kamzave të pemëve frutore;

RM 3 Nxënësi shtrin përparjen e thjeshtë për rrënjëzim.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e materialeve, veglave dhe pajisjeve për

mbjelljen e përpajave për rrënjëzim.

- Transporti i e materialeve, veglave dhe pajisjeve për mbjelljen e përpajave për rrënjëzim në vendin e punës.
- Përzgjedhja e bimës ku do të merret përpaja e thjeshtë.
- Kryerja e hapjes së kanalit për mbjelljen e përpajave.
- Shtrirja e përpajës së thjeshtë në kanal.
- Ngjeshja dhe mbulimi me dhë të shkrifët.
- Vendosja e kunjit mbështetës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë shtrirjes së përpajës për rrënjëzim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për mbjelljen e përpajave;
- të përzgjedhë bimën ku do të merret përpaja sipas karakteristikave përkatëse;
- të hapë kanalën sipas udhëzimeve për mbjelljen e përpajave;
- të vendosë përpajën në thellësinë e caktuar në kanal dhe të nxjerrë pjesën e majës jashtë;
- të mbulojë me dhe të shkrifët dhe të ngjeshë çdo përpajë;
- të vendosë kunjën pranë pjesës së dalë mbi tokë të përpajës;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrirjes së përpajës së thjeshtë për rrënjëzim.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e parcelës në shkollë ose pranë saj, në ferma ku realizohet mbjellja e me pemë frutore të ndryshme.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për mbjelljen e copave të thjeshta, kamzave dhe përpajave të pemëve frutore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për shtimin e drufrutorëve me copa fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me shtimin e pemëve frutore me copa.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për shtimin e pemëve frutore me copa;
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen parcela, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Parcela e mbjellë me pemë frutore të ndryshme
 - Komplet i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për shtimin e pemëve frutore me copa.
 - Plehra të ndryshme organike e minerale.
 - Katalogë dhe manuale për teknikat e shtimit të pemëve frutore me copa të thjeshta.
 - Material mbjellës si copa, kamza, përpaja etj.
 - Hunj mbështetës.
-

6. Moduli “Mbjellja e fidanit të hardhisë”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|---|-------------|
| Titulli dhe kodi | MBJELLJA E FIDANIT TË HARDHISË | M-14-150-15 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të hapur gropën, përgatitur fidanin dhe për të zbatuar teknikat e mbjelljes së fidanit të hardhisë. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 34 orë mësimore (1 kredite) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi hap gropën për mbjelljen e fidanit. <i>Përmbajtja</i> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglave dhe e pajisjeve të punës për hapjen e gropës për mbjelljen e fidanit të hardhisë.– Kontrolli fizik i veglave të punës.– Transportimi i veglave dhe materialeve të punës.– Përcaktimi i vendit për hapjen e gropave.– Piketimi i tokës për mbjelljen e fidanit të hardhisë.– Teknika e hapjes së gropës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së gropave për mbjelljen e fidanit të hardhisë. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat e duhura të punës për hapjen e gropës: dërrasë mbjellëse, piketa, lopata, bela, hunj, lidhës, gëlqere, furçë dhe përzierje bajgë + deltinë;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës;– të caktojë në vend të përshtatshëm për hapjen e gropës për mbjelljen e fidanit të hardhisë;– të piketojë në largësi të caktuar, sipas llojit ose kultivarit duke respektuar distancat e mbjelljes;– të hapë gropën me vegla dore duke hedhur dheun në të dy krahët e gropës sipas teknikës së duhur, si dhe duke respektuar thellësinë e hapjes;– të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së gropës për mbjelljen e fidanit; | |

RM 2 Nxënësi përgatit fidanin për mbjellje.

Përmbajtja

- Përcaktimi i llojit të kultivarit të hardhisë për mbjellje.
- Teknika e nxjerrjes së fidanit nga shtratifikimi.
- Kontrolli i përgjithshëm i fidanit.
- Zhytja e fidanit në ujë.
- Shkurtimi i rrënjëve të fidanit.
- Zhytja e rrënjëve në përzierjen bajgë-deltinë dhe ujë.
- Transportimi i fidanëve në vendin e mbjelljes
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes e mjedisit gjatë përgatitjes së fidanit për mbjellje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë llojin e fidanit frutor për mbjellje sipas kushteve klimatiko-tokësore;
- të nxjerrë me shumë kujdes fidanët nga shtratifikimi;
- të kontrollojë sistemin rrënjor të fidanëve dhe t'i pastrojë ato;
- të zhytë fidanët në ujë për 1-2 ditë;
- të rifreskojë sistemin rrënjor duke shkurtuar rrënjët e dëmtuara;
- të zhytë sistemin rrënjor në përzierjen bajgë-deltinë dhe ujë sipas raporteve të përcaktuara;
- të transportojë fidanët me kujdes në vendin e mbjelljes;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së fidanëve për mbjellje;

RM 3 Nxënësi mbjell fidanin e hardhisë.

Përmbajtja

- Shpërndarja e plehut organik e mineral pranë gropave të hapura.
- Përzierja e dheut të sipërfaqes me pleh organo-mineral.
- Teknika e mbushjes së gropës me dheun e sipërfaqes së përgatitur.
- Teknika e përcaktimit të qendrës së gropës ku do të mbillet fidani.
- Teknika e mbjelljes së fidanit.
- Mbushja e gropës me pjesën tjetër të dheut.
- Teknika e lidhjes së fidanit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së mbjelljes së fidanit të hardhisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpërndarjë plehun organik dhe mineral pranë gropa të hapura sipas sasisë së nevojshme.
- të përzierjë në mënyrë të njëtrajtshme dheu e sipërfaqes me plehurat organo-minerale;
- të kryejë mbushjes së gropës me dheun e sipërfaqes së përgatitur në 2/3 e thellësisë së saj;
- të përcaktojë qendrën e gropës ku do të mbillet fidani me përdorimin e dërrasës mbjellëse dhe ngulja e hurit në thellësi të gropës;
- të mbjelljë fidanin sipas teknikës së mbjelljes së fidanëve frutorë;
- të mbushë gropë me pjesën tjetër të dheut duke lënë pikën e shartimit 7-8 cm mbi rrafshin e tokës
- të lidhë fidanin me hurin në formë tete pak të lirë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së mbjelljes së fidanëve frutorë;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ose jashtë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të ndryshme të mbjelljes së fidanëve frutorë.
- Të diskutohen metoda për teknikën më të përshtatshme të mbjelljes së fidanëve frutorë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të hapjen e gropës, përgatitjen e fidanit dhe mbjelljen e tij, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryerjen e mbjelljes së fidanit të hardhisë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe toke.
 - Fidanë hardhie.
 - Vegla të punës për hapjen e gropës dhe mbjelljen e fidanëve.
 - Dërrasa mbjellëse.
 - Lidhëse
 - Hunj
 - Piketa
 - Gëlqere
 - Bajgë, deltinë
 - Gërshërë krasitëse etj
-

7. Moduli “Mjelja e kafshëve bujqësore”

Drejtimi: Bujqësi
Niveli: I
Klasa: 11

| <i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|---|--|--------------|
| Titulli dhe kodi | MJELJA E KAFSHËVE BUJQËSORE | M-28-1138-15 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të zbatuar teknikat e mjeljes së kafshëve bujqësore me dorë dhe me mjelëse mekanike. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 34 orë mësimore (1 kredit) | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e kl. 10 të drejtimit “Bujqësi”, niveli I. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Nxënësi kryen përgatitjet për mjeljen e kafshëve bujqësore</p> <p><i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e kompletit të veshjes së përshtatshme.– Sigurimi i higjienës personale.– Pastrimi dhe dezinfektimi i mjeteve dhe pajisjeve të mjeljes së kafshëve bujqësore.– Pastrimi i aparatit të mjeljes mekanike të kafshëve bujqësore.– Pastrimi i gjirit të lopës para mjeljes.– Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes për mjeljen e kafshëve bujqësore. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë;– të veshë rroba të pastra për punë;– të lajë duart me ujë të ngrohtë e sapun për të siguruar higjienën personale;– të lajë bidonat, kovat dhe gotat mjelëse me ujë të ngrohtë dhe pluhur larës;– të shpëlajë me ujë të rrjedhshëm bidonat dhe gotat mjelëse dhe t’i kullojë mirë ato;– të pastrojë gjirin e lopës me pece të lagur, me ujë të ngrohtë;– të fshijë gjirin e lopës me pece të thatë duke e fërkuar lehtë– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik gjatë përgatitjes për mjelje si dhe të sigurojë qetësi në stallë; <p>RM 2 Nxënësi kryen mjeljen me dorë të kafshëve bujqësore.</p> | |

Përmbajtja

- Përzgjedhja e pajisjeve dhe enëve për mjeljen e kafshëve.
- Vendosja e kafshës në pozicion të përshtatshëm për mjelje.
- Realizimi i së kafshëve bujqësore.
- Transportimi i qumështit në dhomën e përpunimit.
- Pastrimi i enëve pas mjelës së kafshës.
- Larja e duarve pas mbarimit të procesit të mjeljes me dorë të kafshëve bujqësore.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mjeljes me dorë të kafshëve bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë pajisjet dhe enët për mjeljen e kafshëve;
- të vendosë kafshën në pozicion e duhur për mjelje;
- të realizojë mjeljen e kafshëve bujqësore sipas llojit të kafshës dhe madhësisë së papilave;
- të transportimi qumështin në dhomën e përpunimit të shoqëruar me rregulla të rrepta higjiene;
- të shënojë sasinë në litër të qumështit të mjelë nga kafshët;
- të lajë me ujë të ngrohtë dhe solucion larës enët e qumështit pas mjelës së kafshës;
- të lajë duart pas mbarimit të procesit të mjeljes me dorë të kafshëve bujqësore;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mjeljes me dorë të kafshëve bujqësore;

RM 3 Nxënësi kryen mjeljen mekanike të kafshëve bujqësore.

Përmbajtja

- Kontrolli i aparatit mjelës.
- Pastrimi i gjirit para mjeljes.
- Vendosja e gotave mjelëse në thithat e gjirit.
- Vënia në punë e aparatit mekanik të mjeljes.
- Vrojtimi i daljes së qumështit.
- Heqja nga puna e aparatit mjelës.
- Heqja e gotave mjelëse nga thithat.
- Fërkimi i gjirit dhe shtrydhja e pikave të fundit.
- Transportimi i qumështin në dhomën e përpunimit.
- Pastrimi i enëve dhe i aparatit mjelës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mjeljes mekanike të kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë aparatit mjelës sipas kriterëve të punës;

- të bëjë pastrimin e gjirit të kafshës para mjeljes;
- të vendosë gotat mjelëse me saktësinë thithat e gjirit duke vënë aparatën në pozicionin e duhur;
- të vendosë në gjendje pune aparatën mjelës;
- të vrojtojë e kontrollojë daljen e qumështit derisa të përfundojë mjelja;
- të bëjë ndalimin e punës së aparatit mjelës, në momentin e përfundimit të mjeljes;
- të heqë gotat mjelëse me kujdes, nga thithat e gjirit të kafshës;
- të fërkojë me pece të pastër gjirin dhe të shtydhë pikat e fundit;
- të transportojë me kujdes qumështin në dhomën e përpunimit;
- të pastrojë, siç duhet, enët dhe aparatën mjelës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mjeljes mekanike të kafshëve bujqësore;

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për fermën blegtorale të shkollës ose pranë saj, por rekomandohet të organizohen edhe vizita në ferma blegtorale private ku aplikohen teknikat për lartshënuara të punës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të ndryshme të mjeljes me dorë dhe me aparat mekanik të kafshëve bujqësore.
- Nxënësit, nxiten të diskutojnë mbi metodat e mjeljes së kafshëve bujqësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer mjeljen e tyre, si dhe për pastimin, dezinfektimin dhe mirëmbajtjen e orendive dhe veglave të punës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryerjen e mjeljes së kafshëve me dorë dhe aparat mekanik të mjeljes.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë me kafshë të llojeve të ndryshme.
 - Dezinfektantë.
 - Peshqire, sapun, kova uji.
 - Mjete për fiksimin e kafshës.
 - Aparat mjelës.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për mjeljen mekanike ndihmëse.
 - Kompleti i veshjes.
-

-
- Manuale ose katalogje për mjeljen e kafshëve.
 - Fotografi me pamje të punëve të ndryshme gjatë mjeljes me dorë dhe të mekanizuar të kafshëve bujqësore.
 - Pamje filmike të proceseve të punës gjatë kryerjes së mjeljes me dorë e në mënyrë të mekanizuar të kafshëve bujqësore.
-